

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit

BSc në Informatikë Biznesi

për SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:
Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

(Maj/2016)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc Informatikë Biznesi

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Shkolla e Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti I Shkencave Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr 225, datë 04.06.2013
4	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në “Informatikë Biznesi”
5	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
7	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
15	Aktivizimi i programit të studimit	2013-2014
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve etj	Nuk ka studentë të diplomuar
17	Numri i studentëve	86 studentë

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Ky raport është hartuar në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga APAAL, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, informacionet e marra gjatë vizitës në SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” si dhe takimet dhe intervistat që u zhvilluan gjatë vizitës në këtë institucion.

Shkolla e Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë” është themeluar në vitin 2007. SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” është liçensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 19.02.2009 “Për dhënien e lejës për hapjen e institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”. Ajo ushtron aktivitetin si një institucion i arsimit të lartë privat (jopublik), në bazë të Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe është laike dhe me karakter jopolitik.

Struktura akademike e SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” përbëhet nga 2 (dy) fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Ekonomike
2. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike

Në SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ofrohen programe studimi në dy cikle studimi:

1. Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor 5 programe)
2. Cikli i Dytë i Studimeve (Master Shkencor 5 programe dhe Master Profesional 4 programe)

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” është akredituar institucionalisht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.124, datë 29.03.2012. Programet Bachelor janë akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.124, datë 29.03.2012. Programet Master janë akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.291, datë 11.07.2012.

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi

Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Ekonomike, nën drejtimin e Dekan Prof. Asoc. Dr. Alqi Naqellari. Ky program është hapur në vitin akademik 2013-2014, i liçensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 225, datë 04.06.2013. Në këtë program janë të regjistruar dhe ndjekin studimet aktualisht 86 studentë. Studimet bachelor në këtë program studimi zgjasin tre vjet/gjashtë semestra. Forma e studimit është studime me kohë të plotë dhe studentët për tu diplomuar duhet të realizojnë 180 ECTS (kredite). Pjesa më e madhe e këtyre krediteve i takojnë formimit bazë të studentit kurse pjesa tjetër formimit të përgjithshëm të tij. Në përfundim të programit të studimit studentët pajisen me diplomë: Bachelor në Informatikë Biznesi.

Pas përfundimit të këtij programi të studimit, në sajë të njohurive të marra, studenti aftësohet për mundësinë e punësimit në biznesin privat dhe publik, në pozicione të tilla si: specialistë informatike për biznesin, specialistë fillestar në menaxhimin e sistemeve të informacionit, specialist të TI, zhvillues i faqeve të internetit (web-it), zhvillues programesh aplikative ose jo (software – ve), programues, mirëmbajtës bazash të dhënash, administratorë rrjeti, etj.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

Më 05.05.2016 nga APAAL në Instiucion dërgohet Draft Raporti I Vlerësimit të Jashtëm. Më 10.05.2016 nga Institucioni vjen shkresa “Dërgohet përgjigje Tuajës, Nr 25/8 prot, datë 05.05.2016 “ Dërgohet Draft Raporti I Vlerësimit të Jashtëm””.

Pas njohjes me Komentet nga ky Institucion mbi Draft RVJ, Ekspertja e Vlerësimit të Jashtëm, konsideron vetëm pikën 1 dhe pikën 5 duke reflektuar ndryshimet sipas sugjerimeve të Institucionit. Përsa i përket pikave të tjera, janë Informacione shtesë që paraqet Instiucioni të cilat nuk sjellin të nevojshëm ndryshimin e Raportit të Vlerësimit.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Misioni i “Shkollës së Lartë Private Mesdhetare të Shqipërisë” është të kontribuojë në zhvillimin e Arsimit të Lartë, nëpërmjet arsimit cilësor universitar në fushën e shkencave ekonomike, juridike, politike, marrdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë. Qëllimi i saj është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektivave të zhvillimit të vendit dhe rajonit.

Nëpërmjet Urdhërit Nr.124, datë 29.3.2012 për Akreditimin Institucional dhe të Programeve të Studimit “Bachelor” në “Ekonomi”, “Marrëdhënie Ndërkombëtare/Diplomaci”, “Shkenca Politike-Administratë Publike” të Institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, urdhëroi:

1. Akreditimin institucional, në përputhje me vendimin nr. 303, datë 13.1.2012 të Këshillit të Akreditimit, të institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”.
2. Akreditimin në përputhje me vendimin nr. 303, datë 13.1.2012 të Këshillit të Akreditimit, në institucionin “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, të programeve të studimit “Bachelor” në:
 - a) Ekonomi, me profile:
 - i) Financë-bankë dhe kontabilitet;
 - ii) Administrim biznesi;
 - iii) Biznes dhe ligj.
 - b) Marrëdhënie ndërkombëtare/diplomaci;
 - c) Shkenca politike-administratë publike, me profile:
 - i) Administratë publike;
 - ii) Shkenca politike.

Programet e reja të studimeve në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” hartohen në përputhje me tërësinë e programeve egzistuese dhe qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit. Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është hapur në vitin akademik 2013-2014, i liçensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 225, datë 04.06.2013. Ky program është strukturuar në mënyrë të tillë që t’u ofrojë studentëve njohuri shkencore teorike e praktike për aplikimin e njohurive të informatikës në ekonomi e veçanarisht në biznes.

Misioni i këtij programi studimi është të zhvillojë njohuritë thelbësore të informatikës së biznesit që lidhen kryesisht me dizenjimin dhe zbatimin e sistemeve të reja informatike që ndërthuren me teknologjinë e informacionit, biznesin, dhe ekonominë.

Qëllimi i programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është përgatitja e specialistëve të informatikës të cilët zotërojnë njohuri edhe nga fusha e ekonomisë. Gjatë këtij cikli studimi studentët pajisen me njohuritë bazë në fushën e informatikës së biznesit për ti aftësuar në realizimin e analizave të kërkesave për informacion të bizneseve, strukturimin e informacionit në baza të dhënash dhe realizimin e aplikacioneve. Gjithashtu studentët, njihen me funksionimin dhe shfrytëzimin e rrjetave kompjuterike, sikurse marrin njohuri në ndërtimin e aplikacioneve duke përdorur gjuhë programimi të avancuara, si dhe programe të ndryshme aplikative lidhur me

financën e kontabilitetin. Të gjitha këto njohuri dhe aftësi i përgatitin studentët për të qenë konkures në tregun e punës vendas dhe më gjerë, në profile të ndryshme të informatikës së biznesit.

Për të shtuar kapacitetet konkurruese të studentëve në tregun e punës, curricula e programit të studimit përveç njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit përfshin edhe njohuri të bollshme nga fusha e ekonomisë. Sipas rregullores së këtij programi studimi veprimtaritë formuese të programit janë disiplina të formimit të përgjithshëm, karakterizuese, integruese, me zgjedhje dhe njohuri të tjera plotësuese. Qëllimi është aftësimi i studentëve dhe krijimi i specialistëve që u mundësojnë bizneseve shfrytëzimin e mundësive që ofron teknologjia e informacionit në funksion të rritjes së biznesit.

Një disiplinë e tillë prodhon, jo vetëm punësim në të ardhmen, por edhe mundësi të reja për thellim të mëtejshëm të studimeve në Master Shkencor e Profesional të “Sistemeve të Informacionit në Biznes”, “Informatikë”, “Teknologji Informacioni”, “Shkenca Kompjuterike”, “Informatikë Ekonomike”, si edhe në shkenca ekonomike, etj., duke i dhënë kështu një zhvillim si anës akademike edhe asaj praktike në këto drejtime.

Duke mbajtur parasysh kërkesat në rritje në fushën e arsimit të lartë për cilësi në procesin akademik, kërkimin shkencor, infrastrukturën etj., si dhe zhvillimet bashkëkohore në këtë drejtim SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka përcaktuar një varg objektivash strategjike mbi të cilët janë bazuar edhe programet e studimit të cilat ofron ky institucion. Këto objektiva përfshijnë:

- Përgatitjen e studentëve të profilizuar në informatikë të aplikuar në Biznes.
- Marrjen e njohurive bazë ekonomike dhe informatike, duke synuar një kombinim dhe integrim të dy fushave.
- Aftësimin e tyre në aplikimin e njohurive informatike në fushën e biznesit, nëpërmjet aplikacioneve e programeve të ndryshme në lidhje me bazat e të dhënave, rrjetat, zhvillimin dhe menaxhimin e faqeve të internetit duke i dhënë një shtysë të madhe marketingut të drejtpërdrejtë, apo drejtimeve të tjera në përmbushje të kërkesave të tregut me specialist të kësaj fushe.
- Përgatitjen e studentëve që me mbarimin e këtij programi janë të gatshëm të punësohen në institucione të ndryshme (publike apo private) ku njohuritë e marra gjatë studimeve mund t’i shfrytëzojnë për të rritur efektivitetin dhe produktivitetin e institucioneve e kompanive punëdhënëse.
- Nxitjen dhe motivimin e studentëve që njohuritë e marra t’i transformojnë në sipërmarrje inovatore si në të tashmen dhe në të ardhmen.

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka një vizion të qartë për zhvillimin afatgjatë të studimeve në fushën e Informatikës së Biznesit, në kuadrin e strategjisë të institucionit duke synuar:

- Konsolidimin e programeve të studimit të Ekonomisë, Informatikës së Biznesit, Juridikut, Shkencave Politike, Administratës Publike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe programeve të tjera që do të hapen në të ardhmen në të gjitha drejtimet profesionale, pedagogjike, metodike dhe të kombinimit të mësimdhënies më kërkimin shkencor.
- Forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me universitetet e tjera të vendit si edhe universitetet e huaja, në përvojën dhe modelet e të cilave është mbështetur për hartimin e programeve dhe syllabuseve.
- Bashkëpunimin e vazhdueshëm efektiv, eficient dhe produktiv me qeverinë studentore, komunitetin e studentëve dhe komunitetet dhe grupet e interesit në vend.
- Hapjen e ciklit të tretë të studimeve në programet ku zhvillohen të dy ciklet e para të studimit dhe, të ciklit të dytë të studimeve në vazhdim të programit Bachelor në Informatikë Biznesi.

Programi i ciklit të parë Bachelor në Informatikë Biznesi, është konceptuar në mënyrë të tillë, që të krijojë një vijim logjik dhe profesional me programin e parashikuar të ciklit të dytë të studimeve në po këtë profil që pritet të filloi studimet në vitin akademik 2016-2017.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është strukturuar në mënyrë të tillë që t'u ofrojë studentëve dije shkencore teorike e praktike për aplikimin e njohurive të informatikës në ekonomi e veçanarisht në biznes. Ky program studimi përbën një arritje cilësore për objektivat akademike të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, të SHLP "Mesdhetare të Shqipërisë".</p> <p>Objektivat e këtij programi janë një zhvillim i mëtejshëm i misionit të këtij institucioni. Këto objektiva të materializuara në kurrikulën e programit të studimit synojnë pajisjen e studentëve me dije bashkëkohore në fushën e informatikës së biznesit për ti aftësuar ata në realizimin e analizave të kërkesave për informacion të bizneseve, strukturimin e informacionit në baza të dhënash, administrimin e rrjetave kompjuterike, ndërtimin e aplikacioneve, zhvillimin e faqeve ëeb, si dhe përdorimin e programe aplikative lidhur me financën e kontabilitetin. Realizimi i këtyre objektivave ju mundëson studentëve pajisjen me kompetenca profesionale në të dy disiplinat kryesore që karakterizojnë profilin e programit, atë të informatikës dhe të biznesit.</p> <p>Megjithëse SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë" nuk mund të na vinte në dipozicion një studim tregu të mirëfilltë, në bisedat me drejtuesit e institucionit u informuam se ata rregullisht vlerësonin informacionet e marra nga tregu nëpërmjet studimeve të ndryshme të realizuara nga subjekti juridik Qendra Mesdheu sh.p.k., në pronësi të të cilës është SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë". Sipas tyre programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është hartuar pasi janë analizuar kërkesat e tregut të punës duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhguar portalet e punësimit; - Marrë në konsideratë analizat e Zyrës së Karrierës për nevojat për profilin Informatikë Biznesi në tregun e punës; - Marrë në konsideratë nevojat e subjekteve të ndryshme të biznesit në të cilat studentët e këtij institucioni zhvillojnë praktikat mësimore. <p>Në bazë të vëzhgimeve të hollësishme të zhvillimit të tregut të punës, Qendra Mesdheu ka arritur në konkluzionin se profesioni i specialistit të Informatikës së Biznesit është ndër tre profesionet më të kërkuara në treg. Rekomandimet e saj pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi duke mundësuar që ky program studimi, të jetë në përputhje të plotë me politikat ekonomike të zhvillimit të vendit, me nevojat aktuale të zhvillimit të ekonomisë dhe me kërkesën e ndryshimit cilësor të nivelit të investimeve. Në</p>

	këtë aspekt, ky program evidenton, menaxhon dhe zhvillon aplikimin e njohurive të reja në vendimmarrjet inovative ekonomike.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është në përputhje me objektivat strategjike të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, pasi ai është konceptuar në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të saj për zhvillimin afatgjatë të studimeve në fushën e Informatikës së Biznesit duke synuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsolidimin e programit të studimit nga ana profesionale, pedagogjike, metodike dhe të kombinimit të mësimdhënies me kërkimin shkencor. - Forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me universitetet e tjera të vendit dhe të huaja për mbështetjen e këtij programi. - Bashkëpunimin efektiv, eficient dhe produktiv me qeverinë studentore, komunitetin e studentëve dhe komunitetet dhe grupet e interesit në vend. - Hapjen e ciklit të të dytë të studimeve në vazhdim të programit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Biznesi. <p>Bazuar në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi si dhe programet e njësive të lëndëve për këtë program studimi, temat dhe njohuritë e përcaktuara mund të klasifikohen përgjithësisht si njohuri bazë. Nëpërmjet këtij programi studentët mund të marrin konceptet bazë ekonomike si në manaxhim, financë, kontabilitet, marketing etj., si edhe në disiplinat informatike që ju përshtaten atyre si menaxhimin e sistemeve të informacionit, administrimin e rrjetave, ideimin, zhvillimin e administrimin e bazave të të dhënave, programimin ëeb e mobile, si dhe programe të tjera aplikative lidhur me financën e kontabilitetin.</p> <p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi përveç lëndëve që janë pjesë e formimit të përgjithshëm mbi metoda dhe parime shkencore përfshin gjithashtu një sërë lëndësh të cilat së bashku me praktikat profesionale krijojnë mundësi që studentët të fitojnë shprehje profesionale në fushën e informatikës në një kontekst të lidhur ngushtë me aplikimin e saj në ekonomi. Kjo gjë do t’ju japë mundësinë studentëve për të qenë konkurrenca në tregun e punës vendas dhe më gjerë, në profile të ndryshme të informatikës së biznesit.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p>	<p>Programi Bachelor në Informatikë Biznesi në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është hartuar duke i kushtuar një vëmendje nevojave që paraqet tregu i punës në Shqipëri, në rajon dhe më gjerë, treg i ndikuar nga zhvillimet e shpejta në planin ekonomik dhe teknologjik. Kjo vëmendje është pasqyruar më së miri në profilin e</p>

<p>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</p> <p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>studimeve që programi ofron, duke përgatitur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Specialistë ekonomie dhe informatike për biznese të vogla, të mesme dhe të mëdha, në organizata fitimprurse e jo fitimprurse. - Specialistë fillestarë në fushën e ekonomisë për tregun e telekomunikacionit, mediave elektronike, Bankës Qendrore dhe ato të nivelit të dytë, etj. - Specialistë të TI në institucione financiare publike e private. - Etj. <p>Gjatë vizitës në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” në takimet me drejtuesit e institucionit dhe drejtuesit e programit të studimit konstatuam se insitucioni ka identifikuar tregun e punës që synohet të furnizohet nga studentët e diplomuar në këtë programin e studimit duke u mbështetur tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dhënat e INSTAT mbi kërkesat e tregut për punësim, sipas profilit që ofrohet; - Anketa dhe sondazhe mbi kërkesat e punëdhënësve; - Të dhënat e MAS për fluksin e maturantëve drejt IAL publike dhe jo publike; - Programet e ofruara nga IAL publike dhe jopublike konkurrencte, në rajon e Mesdhe; - Numrin e studentëve të profileve të ngjashme të punësuar në dy vitet e para mbas diplomimit. - Programet e ndryshme kombëtare si mundësi afatshkurtër punësimi edhe për studentët e nivelit Bachelor. <p>Një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e nevojës për specialistët e Informatikës së Biznesit është konsideruar edhe numri i dyfishuar i studentëve të rregjistruar nga viti në vit, që kur është hapur ky program studimi në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Në vitin e parë të hapjes së programit ka pasur 10 studentë, në të dytin 21 dhe në të tretin 50 studentë. Gjithashtu janë edhe 5 studentë të tjerë të transferuar nga universitetet të tjera. Një formë tjetër indentifikimi për kushtet e tregut ishte edhe analiza e kërkesave të studentëve për rregjistrim në degë të ngjashme në insitucione të tjera.</p>
<p>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” në kurrikulën e tij nuk përmban elementë të cilët bien ose mund të bien ndesh me interesat kombëtare, që nxisin fobi ose diskrimin. Gjithashtu nga bisedat me drejtuesit, stafin akademik dhe mbështetës, sikurse edhe me studentët nuk u evidentua ndonjë shqetësim në lidhje me këtë çështje. Ata theksuan se në përgatitjen dhe ngritjen e programeve kanë treguar një ndjeshmëri të veçantë ndaj politikave të promovuara mbi bazën e interesit kombëtar dhe politikave prioritare të zhvillimit social e ekonomik të vendit.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” synon që nëpërmjet</p>

	<p>futjes së lëndëve të tilla si “Njohuri mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Shqipërisë dhe vendeve të Mesdheut” në këtë program studimi të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare e më gjërë. Gjithashtu gjatë bisedave që zhvilluam në takimet me grupet e ndryshme konstatoam se ruajtja e vlerave kulturore kombëtare në këtë program fokusohet në shkëmbimet e përvojave më të mira me institucionet e tjera në vend.</p> <p>Nëpërmjet futjes në këtë program studimi të lëndës së “Etikës dhe komunikimit në biznes” synohet të ndërgjegjësohen studentët për rolin e etikës profesionale dhe shoqërore në organizata duke formuar specialistë me profil të lartë profesional dhe me një ndërgjegje të lartë sociale.</p>
--	---

Konkluzione të GVJ:

Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është hartuar brenda kuadrit të misionit dhe qëllimeve të institucionit. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e specialistëve të informatikës të cilët zotërojnë njohuri edhe nga fusha e ekonomisë. Gjatë këtij cikli studimi studentët pajisen me njohuritë bazë në fushën e informatikës së biznesit për ti aftësuar në realizimin e analizave të kërkesave për informacion të bizneseve, strukturimin e informacionit në baza të dhënash dhe realizimin e aplikacioneve, si dhe përdorimin e programeve të financës dhe kontabilitetit.

Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është hartuar duke marrë në konsideratë nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të fushës së informatikës të pajisur me njohuri bazë edhe nga fusha e ekonomisë. Kjo gjë është mbështetur tek studimet e ndryshme për të analizuar kërkesat e tregut të punës të realizuara nga subjekti juridik Qendra Mesdheu sh.p.k., në pronësi të të cilës është SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”.

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” në hartimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi ka vlerësuar mundësitë që ofron tregu i punës për të akomoduar studentët e diplomuar në këtë program studimi duke synuar të plotësojë nevojat e tregut në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar, mbështetur kjo në të dhënat e INSTAT mbi kërkesat e tregut për punësim sipas profilit që ofrohet, anketa mbi kërkesat e punëdhënësve, numrin e studentëve të punësuar të profileve të ngjashme, etj.

Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” nuk përmban elementë që bien ndesh me interesat kombëtare. Për më tepër ky program ka në përmbajtjen e tij lëndë të cilat ndihmojnë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare si dhe në formimin e etikës profesionale dhe shoqërore të studentëve.

2. Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave Ekonomike të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”

Pjesa përshkrimore

Në bazë të Statutit dhe Rregullores së Organizimit të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është i atashuar në strukturën e Fakultetit të Shkencave Ekonomike.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike është një nga dy njësitë kryesore të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Siç përcaktohet në Statutin dhe Rregulloren e Organizimit të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” departamentet dhe qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit konsiderohen njësitë bazë të fakulteteve. Në Fakultetin e Shkencave Ekonomike këto njësi bazë janë:

1. Departamenti i Ekonomisë
2. Departamenti i Financës, Bankës dhe Kontabilitetit
3. Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës
4. Qendra e kërkimit dhe zhvillimit “Instituti për Reforma dhe Zhvillim”.

Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është autoriteti drejtues i Fakultetit. Ai është autoriteti më i lartë për programin e studimit në Informatikë Biznesi dhe përgjigjet për realizimin e misionit dhe veprimtarinë e gjithanëshme të këtij programi të ciklit të parë. Detyrat dhe kompetencat e tij janë përcaktuar në Statutin dhe Rregulloren e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”.

Këshilli i fakultetit është organi kolegjal më i lartë. Ai merr vendime në lidhje me problematikën akademike. Kompetencat e tij përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e Organizimit të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”.

Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti drejtues i Departamentit. Kompetencat dhe detyrat e tij përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e Organizimit të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Secili nga Departamentet ka në përbërjen e tij disa Grup-lëndë, që përbëjnë qelizën më të vogël të kompetencës akademike. Këto struktura janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e lëndëve të përafërta.

Të gjitha strukturat drejtuese në Fakultetin e Shkencave Ekonomike drejtohen nga personel i punësuar me kohë të plotë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nga vizita në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” dhe dokumentacioni që na u vu në dispozicion morrëm informacionin e nevojshëm për të përshkruar me anë të treguesve të matshëm strukturën akademike të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, tregues të cilët nuk pasqyrohen në RVB. Tabelat në Aneks paraqesin të dhëna mbi organizimin dhe drejtimin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. (Aneksi, Tabela 2.1; 2.2; 2.3)

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Personeli akademik, si ai efektiv edhe ai me kontratë, në Fakultetin e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, angazhohet bazuar në kërkesat specifike të departamenteve. Departamentet pas një analize të hollësishme të kapaciteteve dhe shpërndarjes së ngarkesës mësimore konstatojnë nevojën për personel akademik dhe përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve. Pasi hartohen nga Zyra e Burimeve Njerzore, ato miratohen nga Dekani dhe publikohen. Për të realizuar procedurën e përzgjedhjes, Rektori ngre një komision të kryesuar nga Dekani. Kandidatët e përzgjedhur angazhohen me kontratë semestrale ose vjetore. Personeli akademik përzgjidhet me tituj e grada shkencore dhe me përvojë në fushën akademike dhe profesionale mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë së arsimit të lartë.

Në përputhje me Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi ka gradën shkencore “Doktor” dhe së paku duhet të ketë diplomën Master i Shkencave. Në raste të veçanta mund të punësohet në cilësinë e stafit akademik edhe personel i cili nuk zotëron tituj shkencorë por që përfaqësojnë personalitete të mirënjohura ose unikë në fushën e tyre të ekspertizës ose që mbajnë titullin Docent. Procedurat e rekrutimit dhe angazhimit të personelit akademik efektiv përcaktohen nga Statuti dhe Rregullorja e Organizimit të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Kontrata individuale e fillimit të punës nënshkruhet nga Administratori i SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Punonjësit merren në punë me kontrata me afate të përcaktuar, jo më shumë se një vit, të përsëritshme.

Disa nga kriteret mbi të cilat bazohet rekrutimi i personelit akademik janë:

- a) Titulli shkencor që zotëron.
- b) Cilësia dhe standardet e Universitetit ku ka përfutur diplomën bazë dhe titujt shkencorë që zotëron.
- c) Rezultatet personale të aplikantit.
- d) Aktivitetet kërkimore shkencore të realizuara nga kandidati dhe përputhshmëria e tyre me objektivat shkencorë të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”.
- e) Aftësitë komunikuese dhe njohja e etikës.
- f) Objektivat personale afatmesëm dhe afatgjatë në fushën akademike.

- g) Përvoja e punësimit të mëparshëm dhe rekomandimet nga punëdhënësit e mëparshëm.
- h) Përvoja në mësimdhënie në Institucionet e Arsimit të Lartë.
- i) Zotërimi i gjuhëve të huaja, etj.

Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Ekonomike pranë të cilit është atashuar programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi përbëhet nga 57 pedagogë nga të cilët 33 janë personel efektiv dhe 24 janë personel me kontratë. Gjithsej 44 pedagogë (23 PAE + 21 PAK) kanë tituj/grada shkencore ndërsa 13 pedagogë (10 PAE + 3 PAK) të tjerë janë në proces kualifikimi të mëtjeshëm. Gjithashtu fakulteti ka 4 punonjës administrativë të cilët i shërbejnë të tre njësive kryesore të këtij fakulteti.

Raporti Personel Akademik/Student është afërsisht 1 pedagog me më pak se 2 studentë (57/86) dhe raporti Personel Administrativ/Studentë është afërsisht 1 punonjës me 20 studentë (4/86).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Gjatë vizitës në institucion u konstatua se të dhënat e deklaruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm në lidhje me strukturën didaktike dhe numrin e personelit akademik dhe administrativ janë të sakta. Tabelat e mëposhtme paraqesin këta tregues.

Në Tabelën 3.1 dhe Tabelën 3.2. paraqitet numri i personelit akademik për Departamentin e Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës, si Njësia Bazë përgjegjëse e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, të Fakultetit të Shkencave Ekonomike si dhe Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe Personeli Akademik me Kontratë (PAK) sipas titujve/gradave. Në Tabelën 3.3 paraqiten të dhënat sipas kualifikimit të stafit akademik dhe raportet midis tyre. Në Tabelën e 3.4 paraqiten të dhënat sipas seksit dhe në Tabelat 3.5 dhe 3.6 paraqiten të dhënat sipas moshës. (Shih Anekset)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara me drejtuesit dhe punonjësit e burimeve njerëzore u informuam se parimet, kriteret dhe procedurat e punësimit të personelit akademik përcaktohen në Statut dhe në Rregulloren e IAL. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja e personelit realizohet nëpërmjet konkursit. Për këtë qëllim ngrihet një komision ad-hoc nga Rektori, i cili bën vlerësimin paraprak të kërkesave të paraqitura nga kandidatët. ZBNJ i përcjell Komisionit të ngritur nga Rektori dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët. Më pas realizohet intervistimi i kandidatëve, hartohet raporti nga ana e Komisionit, i cili ja dërgon në formë propozimi për miratim Rektorit.. Procedurat rekrutimit që nga shpallja deri tek përzgjedhja e personelit janë të përcaktuara në Rregulloren e Institucionit në nenet 25,26,27.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe materialeve të tjera online (Aneksi 1/3) vërehet se 70% e ngarkesës mësimore në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi realizohet nga</p>

	<p>personel akademik i angazhuar me kohë të plotë.</p> <p>Në lidhje me vlerësimin e personelit, në takimet me grupet e ndryshme u raportua se personeli akademik në ShLP “Mesdhetare të Shqipërisë” i nënshtrohet disa vlerësimeve gjatë vitit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësim nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit (kontroll i procesit të mësimdhënies) 2. Vlerësim nga studentët (pyetsor) 3. Vlerësim nga pedagogët e tjerë (kontroll i procesit të mësimdhënies) <p>Qëllimi i këtyre kontrolleve është rritja e nivelit akademik të mësimdhënies së stafit akademik. Rezultatet e vlerësimit të marra nëpërmjet pyetsorëve ose kontrolleve ju bëhen të ditura pedagogëve nëpërmjet një raporti që përmban përshkrimin e problemeve të konstatuara gjatë kontrollit dhe masat e rekomandimet përkatëse.</p> <p>Pavarësisht se institucioni nuk përdorte ndonjë sistem elektronik specifik për krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të personelit, zyra e personelit dispononte të arkivuara dokumenta të rekrutimit të personelit, njoftimeve për punë etj.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, Zyra e Burimeve Njerzore na vuri në dispozicion gjithë dokumentacionin e hollësishëm të anëtarëve të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, si atë të personelit efektiv edhe atë me kontratë.</p> <p>Drejtuesi i Departamentit të Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës na informoi se ky departament si njësi akademike përgjegjëse për programin e studimit çdo fillim semestri harton listën e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. këto lista më pas dorëzohen dhe ruhen në Zyrën e Burimeve Njerzore, e cila është përgjegjëse për ruajtjen e rekordeve të të gjithë punonjësve në nivel institucional. Gjithashtu në këtë zyrë gjendeshin edhe dokumentacionet e nevojshme për personelin ndihmës mësimor-shkencor dhe atë administrativ. Kjo listë e plotë e personelit akademik dhe ndihmës të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, gjendet gjendet gjithashtu e publikuar në faqen zyrtare on-line të institucionit.</p> <p>Drejtuesit na informuan se kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik përcaktohen në statutin e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” dhe publikohen në internet dhe media në rast të vendeve vakante. Këtë gjë e pohuan edhe pedagogët e rinj të rekrutuar së fundmi të cilët ishin informuar nëpërmjet</p>

	<p>ëeb-it për mundësinë e punësimit në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”.</p> <p>Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi evidentohet që pjesa më e madhe (rreth 80%) e titullarëve të lëndëve kanë gradën, “Akademik”, “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose “Doktor”, ndërsa ajo pjesë që nuk e ka është në proces të studimeve të doktoraturës.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” nuk angazhon ndonjë personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike. Këto orë zhvillohen nga pedagogët e lëndëve përkatëse. Për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të shkollës fakulteti angazhon personel administrativ që i shërben të tre njësive kryesore të tij. Gjatë vizitës në institucion evidentuam se i gjithë personeli si ai akademik dhe ai administrativ është i angazhuar maksimalisht për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi.</p> <p>Praktikat profesionale të studentëve realizohen nën mbikëqyrjen e personelit mësimdhënës. Raporti tutor/student është përafërsisht 1/6, gjë që mundëson në ndjekje të kënaqëshme të mbarëvajtjes së këtij procesi. Gjithashtu në këtë institucion ekziston edhe zyra e karrierës e cila ka si qëllim të ndihmojë studentët në orjentimin drejt tregut të punës. Por nga takimi me studentët konstatuam që studentët nuk kishin informacion të qartë për operimin e saj.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Gjatë intervistave me pedagogët dhe bazuar në dokumentacionin e ofruar në institucion konstatuam se kualifikimi i mëtejshëm profesional i personelit akademik konsiderohej si një gjë shumë e rëndësishme në ndihmë të përmirësimit të punës së çdo pedagogu në auditor si dhe përsosjen e përditësimit të programeve të studimit e përmbajtjes së lëndëve. Në këtë aspekt institucioni nxit kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxitur pjesëmarrjen në projekte kërkimore-shkencore të financuara nga universitete dhe institucione të tjera. - Financuar pjesëmarrjen në konferencë shkencore ose udhëtime studimore në universitete dhe institucione të huaja. - Financuar botimet e pedagogëve në UMSH Press ose ente të tjera botuese, brenda dhe jashtë vendit. - Nxitjen e botimit të artikujve shkencorë në revistën me bord shkencor EUROMEDITERRANEAN (periodik i SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” që prej

	<p>vitit 2010).</p> <p>Institucioni nuk disponon ndonjë bazë të dhënash për programe studimi specifike të ofruara për kualifikimin e stafit akademik.</p> <p>Të gjitha programet e studimit të këtij institucioni të ofruara për studentët gjenden në bazat e të dhënave të institucionit dhe mund të aksesohen elektronikisht nëpërmjet faqes zyrtare ëëë.umsh.edu.al. Gjithashtu mund të gjenden të printuara në Info Point, ku shërbejnë studentë dhe personel ndihmës, si edhe në çdo departament përkatës.</p>
--	--

Konkluzione të GVJ:

Statuti dhe Rregullorja e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” përcakton kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Ky institucion ka nxitur rekrutimin e personelit të kualifikuar shkencor, duke dokumentuar procesin. Në këtë kuadër janë afruar në Departamentin e Informatikës, Matematikës e Mbështetës pedagogë me përvojë në fushën e Informatikës dhe Ekonomisë, personalitete të njohura në fushat përkatëse, ndër të cilët dhe Akademikë, Profesorë e Profesorë të Asociuar me qëllim kompletimin e stafit dhe vënies në jetë hap pas hapi të objektivave të strategjisë së zhvillimit të institucionit. Personeli akademik informohet për objektivat e programit të studimit dhe strategjitë e zhvillimit të institucionit nëpërmjet një dokumentacioni të gjerë. 70% e ngarkesës mësimore mbulohet me personel akademik me kohë të plotë ndërsa pjesa tjetër nga personel akademik me kohë të pjesëshme. Kontratat individuale të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi përcaktojnë qartësisht detyrimet e tyre në lidhje me realizimin e procesit të mësimdhënies dhe aktiviteteve të lidhura me të. Personeli ndihmës funksionon në nivel institucioni dhe angazhohet në plotësimin e nevoja dhe objektivave të tij. Pavarësisht se institucioni nuk përdorte ndonjë sistem elektronik specifik për krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të personelit, zyra e personelit dispononte të arkivuara dokumenta të rekrutimit të personelit, njoftimeve për punë, etj. Kualifikimi i mëtjshëm profesional i personelit akademik konsiderohej si një gjë e rëndësishme në ndihmë të përmirësimit të punës së çdo pedagogu në auditor si dhe përsosjen e përditësimin e programeve të studimit e përmirësimit të lëndëve. Në këtë aspekt institucioni nxit dhe financon kualifikimin e mëtjshëm të stafit akademik nëpërmjet formave të ndryshme.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ushtron veprimtarinë e saj në ambiente me një sipërfaqe shfrytëzimi 3056 m². Konkretisht këto ambiente të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” ndodhen në adresën: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52, Kodi Postar: 1023, Tiranë. Godina përbëhet nga 6 nivele: 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë. Godina është një ndërtim relativisht i ri. Ndërtimi i saj ka përfunduar në vitin 2010 dhe është marrë me qera për një periudhë kohore mbi 10 vjet.

Informacion për Objektivin

Objekti në të cilin ndodhen ambientet e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është pjesë e një zone strategjike përsa i përket jetës universitare pasi gjendet në afërsi të dy universiteteve të tjera: Universitetit të Tiranës (Fakulteti i Shkencave Politike) dhe SHLP “Universiteti Evropian i Tiranës”. Objekti është ndërtuar sipas të gjitha kushteve teknike të projektimit e zbatimit të standardeve Evropiane, të aplikuara në vendin tonë dhe siguron qëndrueshmërinë statike për sigurinë maksimale të jetës. Për më tepër, infrastruktura e objektit ofron mundësi edhe për personat me aftësi të kufizuara.

Niveli -1 (kati i nëndheshëm): Në këtë nivel gjendet një sallë e madhe konferencash me 120 vende dhe sipërfaqe 104 m², biblioteka me sipërfaqe 107 m², dy magazina, dy tualete, kafazi i shkallëve dhe dy ashensorëve si dhe dhomë teknike me sipërfaqe 50m². Ky nivel lidhet me nivelet e mësipërme nëpërmjet dy palë shkallëve dhe dy ashensorëve. Ky nivel ka një sipërfaqe totale ndërtimi 540m².

Niveli 0 (kati përdhes): Ky nivel ka sipërfaqe ndërtimi 468m². Në këtë nivel janë të vendosura recepsioni, zyra e administratës dhe 5 tualete. Gjithashtu në këtë nivel gjendet një bar bufe për shërbimin studentor dhe një sallë e hapur ndenjeje. Niveli 0 lidhet me nivelet e mësipërme nëpërmjet dy palë shkallëve dhe dy ashensorëve.

Niveli 1 (kati i parë): Në një sipërfaqe ndërtimi prej 517m², në këtë nivel janë vendosur salla kryesore e leksioneve me sipërfaqe 101.6 m², dy salla seminaresh me sipërfaqe 47 m² secila, një Laborator TI me sipërfaqe 46.4 m² dhe tre salla pedagogësh, pesë tualete. Niveli 1 lidhet me nivelet e mësipërme nëpërmjet një palë shkallëve dhe dy ashensorëve.

Niveli 2 (kati i dytë): Ky nivel ka gjithashtu një sipërfaqe ndërtimi 517m². Në këtë nivel gjendet një sallë leksioni me sipërfaqe 101.6 m², pesë salla seminaresh me sipërfaqe të ndryshme, një Laborator TI me sipërfaqe 20 m², pesë tualete dhe dy salla pedagogësh. Niveli 2 lidhet me nivelet e mësipërme nëpërmjet një palë shkallëve dhe dy ashensorëve.

Niveli 3 (kati i tretë): Në nivelin e tretë janë të vendosura, një sallë leksionesh me sipërfaqe 110 m², arkiva, tre salla seminaresh, tre salla pedagogësh dhe pesë tualete. Niveli 3 lidhet me nivelet e mësipërme nëpërmjet një palë shkallëve dhe dy ashensorëve dhe ka sipërfaqe ndërtimi 517m².

Niveli 4 (kati i katërt): Kati i katërt ka një sipërfaqe ndërtimi 497m². Në këtë kat janë të vendosura sallat e pedagogëve, zyra e dekanit, rektorit dhe shefave të departamenteve dhe tre tualete. Ky kat lidhet me katet e mëposhtme me dy palë shkallë dhe me ashensor.

Të gjitha këto ambiente janë plot dritë me ndriçim natyral mbi 50%. Në çdo kat gjenden kuti të ndihmës së shpejtë dhe fikëse zjarri të lëvizshme dhe statike. Gjithashtu ka depozita uji dhe gjenerator të cilat sigurojnë furnizimin e pandërprerë me ujë dhe energji. Godina ka një shesh të gjelbëruar përpara me ambiente pushimi për studentët.

Sallat e leksioneve janë të pajisura me pajisjet e nevojshme (projektor, sistem ngrohje dhe ftohje me kondicionim-ventilim etj.) në funksion të zhvillimit të procesit mësimor duke iu ofruar komoditetet e nevojshme studentëve dhe stafit akademik. Një element tepër funksional dhe domethënës është prezenca e sinjalistikës së lëvizjes apo shpërndarjes së ambienteve dhe emërtimi i tyre. Godina është e pajisur me internet wireless në të gjitha ambientet e saj dhe është e aksesueshme për të gjithë studentët.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Tabela 4.1: Mjediset e institucionit dhe Tabela 4.2 Mjediset për stafin (Anekset)

- Numri i PC për studentët: 22
- Numri i PC për stafin akademik: 27
- Numri PC për administratën: 10
- Printer kombinat stacionar rrjeti: 5
- Printer lokal:2
- Fotokopje kombinat stacionare rrjeti: 8
- Videoprojektorë: 12

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka vënë në dispozicion të studentëve të programit Bachelor në Informatikë Biznesi tekste mësimore të hartuara nga pedagogët e tij, si dhe nga pedagogë më me emër të universiteteve të tjera në vend. Po ashtu, edhe leksionet e shkruara zënë një vend të konsiderueshëm për lëndët dhe kurrikulat e reja. Përprjekje paraprake janë bërë edhe për sigurimin e literaturës ndihmëse cilësore.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion na u raportua se SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” në mënyrë konstante mbështet me fondet monetare pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj. Biblioteka ka siguruar një literaturë të pasur, në ndihmë të studentëve, pedagogëve për kërkim shkencor. Numërohen rreth 50 tituj të ndryshëm të fushës së Informatikës dhe mbi 500 tituj të ndryshëm të fushës së Ekonomisë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Janë libra të karakterit fundamental shkencor, botime të mendimit alternativ, si dhe të profileve të shkollave të ndryshme të mendimit.</p> <p>Sipas raportimeve të marra gjatë bisedave me personelin e Institucionit, pjesa më e madhe e këtij fondi ka hyrë në bibliotekë në dy vitet e fundit akademikë për faktin se me hapjen e programit fillimisht u siguruan ata tituj librash që lidheshin me kurrikulën e tre viteve të parë akademikë. Fondi i bibliotekës është pasuruar me dhurime librash nga OSBE, Banka Botërore, Kuvendi i Shqipërisë dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan.</p> <p>Biblioteka ofron libra të cilët janë rekomanduar sipas syllabuseve lëndore të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi dhe tekste bashkëkohorë. Në bibliotekë është i mundur shfrytëzimi nga ana e studentëve i mundësive të krijuar nga institucioni për formimin sa më të plotë të studentëve duke përdorur forma të ndryshme jo vetëm tradicionale por dhe bashkëkohore. Këto konsistojnë në ofertën e një biblioteke ku studentët gjejnë tekstet bazë, dhe jo vetëm, në format hard copy apo elektronike.</p> <p>Në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” përgjegjësi i çdo programi studimi, është në kontakt të vazhdueshëm me pedagogët e lëndëve duke synuar përditësimin e literaturës së përdorur dhe shtimin e zërave të bibliotekës, duke përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.</p>

Universiteti qëndron i hapur nga ora 8.30 deri në orën 19.30. Për këtë arsye, për t'i qëndruar sa më afër kërkesave dhe nevojave të studentëve është vendosur që biblioteka të punojë me të njëjtin orar. Gjatë kësaj kohe një punonjës i bibliotekës që qëndron gjithnjë në dispozicion të studentëve për orientimin e tyre në të.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” zhvillon veprimtarinë e vet në 1 godinë me një sipërfaqe 3056 m² e cila gjendet në adresën: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52, Kodi Postar: 1023, Tiranë. Godina është një godinë relativisht e re, e ndërtuar vitet e fundit, me materiale cilësore të standardeve ISO, brenda standardeve të kërkuara nga autoritetet përkatëse.

Ambiente ku zhvillohet mësimi dhe zyrat janë të ndriçuara maksimalisht, me mbi 50% ndriçim natyral, me akustikë, me sistem individual kondicionimi për ngrohje dhe ftohje.

Sallat janë të pajisura me projektorë, me qasje në internet nga çdo vendndodhje në sipërfaqen e godinës.

Për zhvillimin e procesit mësimor dhe në funksion të studentit janë ambientet si mëposhtë:

Mjediset për Fakultetin e Shkencave Ekonomike	Sasia	Sipërfaqja (m ²)
Salla për leksione	7	558.2
Klasa për seminare	10	398.4
Salla për aktivitete promovuese	1	104
Laboratorë	2	70
Salla interneti	1	46.4
Salla për bibliotekë	1	107
Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1	35.2

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka një infrastrukturë të përshtatshme, si nga klasat që disponon, ashtu dhe nga pajisjet e tyre që bëjnë të mundur një mësim në standarde bashkëkohore. Në funksion të një procesi mësimor për aftësimin praktik të studentëve, përveç orëve mësimore teorike, në syllabuset e lëndëve të programit të studimit BSc. në Informatikë Biznesi janë parashikuar edhe zhvillimi i orëve mësimore në laboratorë të informatikës. Për këtë qëllim shkolla

	<p>ka ngritur 2 laboratorë informatike me pajisjet dhe softëare të nevojshëm për realizimin e programit mësimor. Laboratori i informatikës, i vendosur në ambientet e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, i bën të mundur studentit të sigurojë dhe të përdorë informacionin e marrë në funksion të lëndëve/moduleve përkatëse. Konstatuam se numri i kompjuterave në këta laboratorë ishte i pamjaftueshëm për të kënaqur nevojat e të gjithë studentëve të të tre viteve të programit të studimit. Gjithashtu edhe në takimet me studentët, këta të fundit kishin rezerva në lidhje me numrin e pamjaftueshëm të kompjuterëve në këto laboratorë. Në planet mësimore të programit të studimit BSc. në Informatikë Biznesi që ofrohet në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, është planifikuar që studenti kryen rreth 120 orë praktikë mësimore/profesionale pranë institucioneve dhe shoqërive private ose edhe shtetërore, të miratuara nga SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”. Kjo praktikë vlerësohet me notë dhe me kredite. Praktika zhvillohet në një nga organizatat/kompanitë publike/private që SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjithashtu nëpërmjet formularit të miratimit të praktikës, studenti ka të drejtë të propozojë për zhvillimin e praktikës në kompani tjetër (jo të listuar nga SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”). Departamenti pasi shqyrton propozimin e studentit lidhur me kompaninë miraton ose jo zhvillimin e praktikës pranë kësaj kompanie nga ana e studentit. Organizimi dhe zhvillimi i praktikës profesionale kryhet në bazë të rregullores për praktikën profesionale.</p>
--	--

Konkluzione të GVJ:

GVJ shqyrtoi me kujdes kërkesat e kritereve të standardit të kërkuar. Nisur nga verifikimi i përputhshmërisë së veprimtarisë me kërkesat e kritereve të standardeve, GVJ vlerëson se SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” vendos në dispozicion të studentëve sasi të mjaftueshme ambientesh të përshtatshme për mësimdhënie. Këto ambiente janë të pajisura me mjete dhe infrastrukturë bashkëkohore dhe plotësojnë nevojat për realizimin e objektivave të programit të studimit BSc. në Informatikë Biznesi. Për realizimin e orëve laboratorike të parashikuara në planin mësimor të programit të studimit, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” vendos në dispozicion të studentë 2 laboratorë informatike. Pavarësisht kësaj, studentët shprehën rezerva për pamjaftueshmëri të numrit të kompjuterëve në këto laboratorë.

GVJ është i mendimit se përgjithësisht SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” i plotëson standardet e kërkuara. Marrëveshjet e nënshkruara me organizata të ndryshme, mundësojnë plotësimin e nevojave për realizimin e praktikave profesionale të studentëve që ndjekin programin e studimit BSc. në Informatikë Biznesi. GVJ vlerëson se pavarësisht funksionimit të rregullt të bibliotekës në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, është e nevojshme që ajo të pasurohet me më shumë tituj dhe sidomos përsa i përket qasjes në revista/periodikë shkencorë ndërkombëtarë.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

SHLP Mesdhetare e Shqipërisë është projekt i OJF “Qendra Mesdheu”. OJF “Qendra Mesdheu” është regjistruar me Vendim Nr. 411, datë 06.07.2007 të Gjykatë së Rrethit Tiranë si person juridik dhe si objekt të aktivitetit ka realizimin e ushtrimit të aktivitetit në fushën e arsimit të lartë privat, dhe rezultojnë në Rregjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. (Ligji Nr. 8788, “Për Organizatat Jo Fitimprurëse” dhe Ligji nr. 8789, “Për Regjistrimin e Organizatave Jo Fitimprurëse”). Bordi i “Qendra Mesdheu” është autoriteti vendimarrës në hartimin e politikave financiare dhe vendimarrjen për menaxhimin e burimeve në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në pesë vitet e fundit (Aneksat, Tabela. 5.1).

Shpenzimet në pesë vitet e fundit sipas burimit të financimit (Aneksat, Tabela. 5.2).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” është projekt i OJF “Qendra Mesdheu” dhe në bazë të statutit harton Raporte të përvitshme financiare, të cilat i paraqiten Bordit të Qendrës Mesdheu në çdo vit.
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare; Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike; Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka dokumentuar raportet financiare të pasqyruara në bilancin financiar të përgatitur nga AIEI Auditors dhe Auditimi i brendshëm për vitet 2009 e në vijim. SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” dëshmon garancitë e nevojshme financiare në llogaritë e veta bankare.
Konkluzione të GVJ: SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka dokumentuar raportet financiare të pasqyruara në bilancin financiar të përgatitur nga AIEI Auditors dhe Auditimi i brendshëm për vitet 2009 e në vijim. SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” dëshmon garancitë e nevojshme financiare në llogaritë e veta bankare.	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Sigurimi i Cilësisë së proceseve akademike ka karakter gjithëpërfshirës dhe shoqërohet me kërkesa gjithnjë në rritje, për realizimin e të cilave nga secili prej punonjësve të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” kërkohet maksimumi i performancës dhe kualifikimi i vazhdueshëm.

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në mënyrë më specifike është ngritur struktura përkatëse në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” e cila vepron konform kërkesave të Ligjit Nr. 9741, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të datës 21.05.2007, i ndryshuar. Kjo strukturë është emërtuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (për më tej NJSBC). Kjo njësi është ngritur që në fillimet e veprimtarisë të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”.

NJSBC e zhvillon aktivitetin e saj, përveç sa parashikon statuti dhe rregullorja e shkollës, në përputhje me rregulloren e brendshme të NJSBC dhe planin e përvitshëm, në të cilin planifikohen kontrollet në njësitë apo proceset që i nënshtrohen kontrollit, e që shoqërohen me raporte me gjetjet përkatëse. NJSBC në mënyrë periodike informon Senatit Akademik dhe Autoritet Drejtues rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si në kuadër të institucionit apo njësive të tij ashtu dhe të personelit akademik.

Nëpërmjet aktiviteteve në kuadër të sigurimit të cilësisë (tavolina rrumbullake, ëorkshope, biseda të lira, trajnime, etj) është synuar që të futet kultura e cilësisë në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Kërkesat në rritje për një cilësi sa më të lartë dhe përvoja e fituar në vite kanë shtruar nevojën për një transparencë në tërë proceset akademike që realizohen përmes paraqitjes dhe njohjes në ëeb-siten e shkollës të dokumentacionit rregullues të shkollës, konkretisht të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” etj, legjislacionin përkatës, urdhrat e rektoratit të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, etj. Në këtë kuadër, për secilin program/syllabus lëndë, është hartuar një format standard me të gjithë elementet e nevojshëm të një syllabusi. Gjithashtu, për sigurimin e cilësisë janë bërë drejtpërdrejt takime/biseda të drejtuesve të institucionit me studentët, apo përdorimi periodikisht i pyetësorëve me studentët në kuadër të tërheqjes së opinionit të tyre mbi programin e studimit, për çdo lëndë të programit dhe pedagog. Pas procesit të përpunimit të këtyre gjetjeve, informacioni përkatës i kalon titullarëve të institucionit si dhe organeve kolegjiale përkatëse çdo fund viti akademik. Ky informacion ndër të tjera shërben për vlerësimin dhe procesin e vazhdimësisë të performancës së institucionit, të njësive apo të secilit pedagog.

Nga veprimtaritë dhe rezultatet e sipërcituara për sigurimin e brendshëm të cilësisë, tashmë është krijuar përvoja e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, si dhe janë marrë një sërë masash me karakter organizativ dhe metodik. Kështu, përveç forcimit të rolit të departamentit në proceset akademike, janë propozuar forma të reja për kontrollin e dijeve të fituara nga studentët duke i dhënë përparësi punës individuale të studentëve.

Gjatë periudhës 2013-2016 janë zhvilluar disa takime studentësh të programit të studimit BSc në Informatikë Biznesi. Ndër çështjet themelore që u ngritën ishin problematikat e lidhura me procesin e mësimdhënies; nevoja e organizimit të më shumë veprimtarive apo aktiviteteve dhe përfshirja e studentëve në projekte të ndryshme etj.

Një nga format me të përdorura mbi matjen e sigurimit të cilësisë në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është pyetësori me studentët. Pyetësori realizohet dy herë në vit (në fund të çdo semestri), për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve janë përpunuar dhe rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit. Më pas këto rezultate i vihen në dispozicion në mënyrë të personalizuar secilit pedagog. Njëherazi, ato kanë qenë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e procesit të mësimdhënies, të punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndër problemet më kryesore kanë qenë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontroll, etj.

Si rrjedhojë, janë planifikuar masa si funksionimi i këshillimit të studentëve përmes zyrës së këshillimit të karrierës dhe përforcimi i rolit të tutoriatit (mentorit) për secilin pedagog, përforcimi i

përdorimit në funksion të komunikimit i rrjeteve sociale si p.sh. faqja zyrtare e shkollës në Facebook; përfshirja e studentëve në projekte të ndryshme, asistenca për aplikime dhe shkolla verore; forcimi i rolit të secilit departament, marrëveshje bashkëpunimi me organizata publike dhe private për panairin e punës, pasurimi me infrastrukturë dhe burime njerëzore i zyrës së këshillimit të karrierës etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

(ANEKSET, Tabela. 6.1: Anëtarët e NJSBC)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve, duke marrë informacion të detajuar mbi ngarkesën mësimore, me anë të anketimeve dhe intervistave të ndryshme, duke u bazuar në një informacion të plotë administrativ mbi realizimin e planit mësimor, gjithnjë në respekt të përshtatjes së ngarkesës dhe të programit me misionin e tij.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka krijuar njësinë e NJSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë), organi ekzekutiv brenda në institucion që merret me Kontrollin dhe Vlerësimin e Cilësisë.</p> <p>Rezultatet mbi kontrollin e cilësisë dhe objektivat që synohen publikohen duke përdorur mjete si: Ëëb, broshura të ndryshme, Guidën e Studentit etj. Ky është një proces në vazhdimësi, dhe si i tillë, është e nevojshme një periudhë e caktuar kohe për unifikimin e metodologjive të kontroll-vlerësimit dhe të raportimit.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit institucioni përdor metoda të tërthorta si dhe të drejtpërdrejta :</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare;

	provime për module, praktikë; d. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka marrë akreditimin institucional me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.124, datë 29.03.2012 dhe ka kërkuar akreditimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.</p> <p>Për sigurimin e cilësisë në statutin e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është përcaktuar njësi e posaçme e cila është: NJSBC</p> <p>Kjo njësi përdor instrumentat të shumëllojshme për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi cilësinë.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, për sa i përket sigurimit të cilësisë mban një qëndrim proaktiv duke vlerësuar periodikisht programet dhe punën e pedagogëve jo vetëm ana e NJSBC-së, duke përpunuar rezultatet e anketimeve, por në vazhdimësi, me analiza nga ana e hallkave të sipërpërmendura, që konsistojnë në analizën e planeve mësimorë, të punës kërkimore etj. Përveç të tjerave, një ndër kriteret që përdoren për vlerësimin e cilësisë së programeve janë statistikatat e punësimit të të diplomuarve.</p> <p>Në rregulloren e NJSBC -së janë shprehur qartë politikatat në fushën e cilësisë. NJSBC ndjek në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programeve dhe punën e pedagogëve në lidhje me respektimin e standardeve. Në fund në lidhje me veprimtarinë e punës së saj, NJSBC -ja përpilon një raport që i paraqitet strukturave vendimmarrëse.</p> <p>Statuti i SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” parashikon ngritjen e strukturave për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron. Ato janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti shqyrton planet mësimore, rishikon programet, shqyrton tekstet duke propozuar ndryshimet eventuale. 2. Këshilli i Fakultetit vlerëson dhe miraton ndryshimet e propozuara nga departamenti. <p>Megjithatë, për shkak të kufizimeve të ligjit aktual për arsimin e lartë ndryshimet në programin e studimit për tu përshtatur me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet teknologjike janë të kufizuara.</p>

Konkluzione të GVJ:

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e gjen të përputhur praktikën e ndjekur nga SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas kriterëve të standardeve të përshkruara. Përgjithësisht, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” i përmbush kriteret e kërkuara.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**7. Programi i studimit, organizimi i tij****Pjesa përshkimore**

Misioni i “Shkollës së Lartë Private Mesdhetare të Shqipërisë” është të kontribuojë në zhvillimin e Arsimit të Lartë, nëpërmjet arsimit cilësor universitar në fushën e shkencave ekonomike, juridike, politike, marrdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë. Qëllimi i saj është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektivave të zhvillimit të vendit dhe rajonit. Në përputhje me këtë mision dhe në përgjigje të kërkesave në rritje të tregut të punës për specialistë të informatikës të aftë të flasin gjuhën e biznesit, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” sjell si pjesë të ofertës së saj akademike programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Ky program studimi ofrohet në Fakultetin e Shkencave Ekonomike.

Misioni i programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është të zhvillojë njohuritë thelbësore të informatikës së biznesit që lidhen kryesisht me dizejnimin dhe zbatimin e sistemeve të reja informatike që ndërthurin teknologjinë e informacionit, biznesin dhe ekonominë.

Qëllimi i programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është të përgatisë specialistë të informatikës të cilët zotërojnë njohuri edhe nga fusha e ekonomisë. Gjatë këtij cikli studimi studentët pajisen me njohuritë bazë në fushën e informatikës së biznesit për ti aftësuar në realizimin e analizave të kërkesave për informacion të bizneseve, strukturimin e informacionit në baza të dhënash dhe realizimin e aplikacioneve. Gjithashtu studentët, njihen me funksionimin dhe shfrytëzimin e rrjetave kompjuterike, sikurse marrin njohuri në ndërtimin e aplikacioneve duke përdorur gjuhë programimi të avancuara, si dhe programe të ndryshme aplikative lidhur me financën e kontabilitetin. Të gjitha këto njohuri dhe aftësi i përgatisin studentët për të qenë konkures në tregun e punës vendas dhe më gjerë, në profile të ndryshme të informatikës së biznesit.

Programi i studimit përmban 180 kredite ETCS dhe është i organizuar në tre vite akademike me kohë të plotë. Çdo vit akademik përmban 60 kredite ETCS. Çdo kredit ETCS përcaktohet si 25 orë mësimore/pune për studentin. Çdo vit akademik është i organizuar në 2 semestra.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Biznesi ka filluar në vitin akademik 2013-2014. Forma e studimit është: me kohë të plotë - kohëzgjatja 3 vite akademike/6 semestra dhe plotësohen me 180 ECTS.
- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
 - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
 - 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit
 - 1 orë mësimore 50 minuta
- Në përfundim të programit studentët pajisjen me diplomë: Bachelor në Informatikë Biznesi

Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi jepen detaje për lëndët, tipologjinë e lëndës, numrin e krediteve, numrin total të orëve mësimore dhe të ndara në leksione/seminare/laboratorë etj., numrin total të orëve jashtë auditorit si punë e pavarur e studentit, semestrin kur zhvillohet lënda si dhe stafin akademik përgjegjës për lëndën.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi:

▪ Leksionet	12 orë në auditor dhe	13 orë punë e pavarur e studentit
▪ Seminaret	12 orë në auditor dhe	13 orë punë e pavarur e studentit
▪ Laboratorët	12 orë në auditor dhe	13 orë punë e pavarur e studentit
▪ Praktikën Profesionale	20 orë në auditor dhe	5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	4 orë në auditor dhe	21 orë punë e pavarur e studentit

Vlerësimi për Syllabus-et

Syllabuset në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi përmbajnë elementët e mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literaturën e detyruar dhe atë ndihmëse

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” e ofron programin e studimit të ciklit të parë, që përfundon me diplomë universitare Bachelor në Informatikë Biznesi, të organizuar në module dhe të vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit - 1 orë mësimore = 50 minuta <p>Forma e studimit është: me kohë të plotë, kohëzgjatja është 3 vite akademike /6 semestra.</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Për të tre vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë 180</p>

	<p>kreditë.</p>
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike është njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Ky fakultet siguron përgatitjen, organizimin dhe dokumentimin efikas të programit të studimit. Informimi i studentëve lidhur me programet përkatëse është i detyrueshëm. Në departament gjenden informacione për programin, për kurrikulën, për syllabuset, për numrin e orëve dhe kreditet, për pedagogët dhe format e mësimdhënies, për librat si tekste bazë dhe për tekstet alternative, për aksesin në bibliotekë, për mundësinë e informimit on-line apo guidën e studentit.</p> <p>Procesi mësimor organizohet në dy semestra për secilin vit akademik, me 30 javë mësimore (15 javë për secilin semestër) dhe me orar mësimor të detajuar për orët teorike, për orët praktike, për praktikën profesionale, për sezonet e provimeve dhe riprovimeve, etj.</p> <p>Në planin mësimor të miratuar përveç lëndëve të detyruara përfshihen dhe një numër lëndësh me zgjedhje. Detyrimi i informimit shtrihet për të gjitha lëndët pa dallim dhe studentët informohen për të gjitha detajet e nevojshme në të njëjtën mënyrë. Ndër kushtet e nevojshme, për zbatimin e programeve të studimit bën pjesë edhe formimi praktik e profesional i studentëve, me anë të realizimit të procesit të mësimave praktike, praktikave profesionale të mbikëqyrura, etj. Secili nga këto elementë konsiderohet si detyrim kurrikular.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike me anë të formave të ndryshme direkte apo indirekte jep informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit. Informacioni gjendet në syllabuset e lëndëve përbërëse të programit të lëndës dhe në planin mësimor. Dhënia mund të jetë direkte në sekretari, departament dhe dekanat, apo indirekte me forma të publikimit në letër dhe online.</p>
<p>Konkluzionet e GVJ: SHLP “Mesdhetare e SHqipërisë” e përbush standardin e kërkuar, së bashku me kriteret përkatëse, lidhur me ofrimin e programeve të studimit. Nga takimi me përgjegjësin e këtij programi studimi si dhe me studentët që ndjekin këtë program konstatojmë se të interesuarit por edhe studentët aktualë marrin të gjithë informacionin e duhur në lidhje me këtë program studimi. Informacioni konsiston në lëndët/modulet që ofrohen, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, ngarkesën mësimore, orët në auditor (ushtrimet apo laboratore), frekuentimin/ndjekjen e programit praktikën, etj. Informacioni gjendet në syllabuset e lëndëve përbërëse të programit të studimit dhe në planin mësimor. Dhënia mund të jetë direkte në sekretari, departament dhe dekanat, apo indirekte me forma të publikimit në letër dhe online.</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkimore

Procesi i mësimdhënies për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është i organizuar në tre vite akademike ose gjashtë semestra, me kohë të pakufizuar për diplomim, në varësi të kushteve dhe mundësive të studentit. Ai organizohet me shkëputje nga puna me pesë ditë të javës mësim.

Organizimi i mësimdhënies në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” bazohet duke përmbushur kërkesat e legjislacionit në fuqi, sikurse dhe në eksperiencat më të mira brenda vendit edhe ato ndërkombëtare. Bazuar në rolin që çdo disiplinë mësimore ose veprimtari formuese luan në formimin e studentit, lëndët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi organizohen në 6 kategori disiplinash:

Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm bazë

Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit

Kategoria C: Disiplina të ngjajshme dhe/ose integruese

Kategoria D: Disiplina të zgjedhura

Kategoria E: Veprimtaria formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësi kompjuterike, praktika

Kategoria F: Përgatitja e tezës së diplomës

Çdo lëndë zhvillohet në bazë të syllabusit dhe planit mësimor të miratur. Përpara fillimit të semestrit Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës zhvillon mbledhje me pedagogët për të diskutuar në lidhje me azhornimet e syllabuse të lëndëve. Ky azhornim përfshin, tematikat që do të zhvillohen gjatë semestrit, literaturën e rekomanduar, mënyrën e organizimit të mësimdhënies dhe format e kontrollit dhe kriteret e vlerësimit. Veprimtaritë akademike për zhvillimin e lëndëve përfshijnë kombinimin e formave të ndryshme të mësimdhënies të tilla si: leksione, seminare/ushtrime, laboratorë, provime të pjesëshme dhe provimi përfundimtar, si dhe praktika profesionale. Sasia e tyre për secilën lëndë përcaktohet në syllabusin e lëndës përkatëse. Me fillimin e semestrit syllabuset u vihen në dispozicion studentëve. Në këtë mënyrë, studentët njihen me temat të cilat do të zhvillohen gjatë semestrit, mënyrën e oraganizimit të orëve mësimore (leksione/seminare/laboratorë etj.), sikurse me format e kontrollit dhe mënyrën e vlerësimit të tyre. Gjithashtu syllabuset i informojnë studentët mbi literaturën bazë të lëndës dhe atë plotësuese.

Për realizimin e veprimtarive mësimore gjatë semestrit, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, vë në dispozicion ambiente të përshtatshme për llojin e formën e mësimdhënies dhe të pajisura me mjetet e duhura didaktike. Mjetet didaktike janë tabela, kompjuteri, projektori. Gjatë leksioneve punohet me dërrasën dhe me projektor. Shkrimi në dërrasë dhe ndjekja e arsyetimit duke shkruar në tabelë është shumë e rëndësishme për studentin. Seminarët, për lëndët e profilit karakterizues të programit zhvillohen në laborator. Në këtë mënyrë studentët kanë mundësi të aplikojnë njohuritë teorike duke i aftësuar ata në aspektin praktik. Kjo e bën mësimin tërheqës dhe më të kuptueshëm për studentin. Ajo që vihet re është se numri i kompjuterave në laboratorin e informatikës (16 kompjutera) është relativisht i vogël në krahasim me numrin e studentëve të rregjistruar në këtë program studimi (81 studentë). Për lëndët të cilat nuk kërkojnë kushte/pajisje specifike gjatë zhvillimit të seminareve, ambientet e vëna në dispozicion janë të pajisura me mjetet didaktike bazë. E zakonshme është që seminari zhvillohet duke zgjidhur bashkërisht ushtrime, ku studentët aktivizohen.

Vlerësimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren dhe mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Kontrolli i dijeve, i propozuar nga pedagogu dhe i sanksionuar në syllabusin dhe planin mësimor, zbatohet duke u kontrolluar nga Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës dhe dekanati i Fakultetit të Shkencave Ekonomike. Vlerësimi i studentit përbëhet nga disa komponentë: pjesëmarrja në auditor, provimet e pjesëshme dhe provimi përfundimtar. Pesa specifike e secilit prej tyre në vlerësimin përfundimtar është pjesë e syllabusit të lëndës. Elementët e vlerësimit për secilin student dokumentohen nga titullari i çdo lënde dhe i bashkëngjiten fletës së provimit. Provimet arshivohen dhe ruhen pranë departamentit përkatës për një periudhë 6-mujore. Çdo rezultat nuk formalizohet pa i dhënë kohë studentëve për ankimim sipas përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit.

Me mbarimin e programit teorik, studenti zhvillon praktikën profesionale. Praktika zhvillohet në një nga organizatat/kompanitë publike/private që SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjithashtu nëpërmjet formularit të miratimit të praktikës, studenti ka të drejtë të propozojë për zhvillimin e praktikës një kompani tjetër (jo të listuar nga SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”). Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës pasi shqyrton propozimin e studentit lidhur me kompaninë miraton ose jo zhvillimin e praktikës pranë kësaj kompanie nga ana e studentit. Organizimi dhe zhvillimi i praktikës profesionale kryhet në bazë të rregullores për praktikën profesionale. Gjatë zhvillimit të praktikës secilit student i caktohet një pedagog efektiv i departamentit i cili ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikës. Në përfundim të programit të studimit studentët i nënshtrohen provimit të diplomimit, realizimi me sukses i të cilit finalizon ciklin e parë të studimeve dhe i pajis ata me Diplomë Bachelor në Informatikë Biznesi.

Cilësia e mësimdhënies është objektiv madhor i SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Elementi kryesor për arrijen e këtij objekti, në këndvështrimin e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është rekrutimi i një stafi akademik sa më të kualifikuar nga pikëpamja akademike, pedagogjike (eksperiencë në mësimdhënie) edhe nga ajo profesionale (praktike). Për realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, bazuar tek plani mësimor i marrë gjatë vizitës në institucion, janë angazhuar 19 pedagogë të cilët kanë grada shkencore Prof. Dr. (4), Prof. Asoc. (4) dhe Dr (11), ndërkohë që 7 të tjerë janë në proces të marrjes së gradës Doktor. Shumica e stafit akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies ka eksperiencë të konsiderueshme në mësimdhënie. Një kujdes të veçantë i kushtohet ngarkesës mësimore të pedagogëve. Ngarkesa mësimore bazohet në rregulloren për ngarkesën mësimore. Përveç ngarkesës mësimore sipas rregullores, Dekanatet dhe Rektorati motivojnë dhe përpiqen të angazhojnë pedagogët në kërkime shkencore dhe në veprimtari në mbështetje të institucionit. Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, Dekanati i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës harton raporte semestrale mbi kontrollin e cilësisë të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mundësitë e përmirësimit të programit të lëndës apo veprimtarive akademike bazuar në eksperiencën e mëparshme. Pjesë e procesit të sigurimit të cilësisë në mësimdhënie është edhe organizimi periodik i anketeve me studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, si dhe kontrollet që bëjnë grupe pedagogësh të caktuar për të ndjekur procesin mësimor të kolegëve të tyre.

Studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi janë aktivizuar vazhdimisht në aktivitete të ndryshme të departamentit. Të gjithë pedagogët punojnë me grupe të ndryshme studentësh që i vlerësojnë si më të përgatitur në lëndë të caktuara duke i bërë pjesë të punës shkencore që zhvillohet në departament. Një pjesë e studentëve janë angazhuar në punime konkrete që iu kanë ngarkuar pedagogët sipas studimeve shkencore që këta pedagogë po kryejnë. Angazhimi i studentëve ka qenë kryesisht në ndjekjen e aktiviteteve shkencore si dëgjues, por edhe në punime konkrete, psh janë përzgjedhur për të grumbulluar material statistikor në favor të punimeve të ndryshme që realizohen nga pedagogët me qëllim që puna shkencore të jetë diçka e prekshme nga studenti krahas procesit të detyrueshëm mësimor. Një tjetër angazhim i iniciuar nga vetë studentët është krijimi i faciliteteve kompjuterike për bibliotekën e shkollës nëpërmjet krijimit të një aplikacioni Eëb dhe më pas Mobile. Ky aplikacion fillimisht do të ndihmojë studentët të informohen në kohë reale mbi librat dhe materialet shkollore që ndodhen në bibliotekë dhe më pas do të trajtohet mundësia për komunikimin dhe përdorimin online të bibliotekës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet: (Anekset, Tabela 8.1)
- Format e kontrollit të njohurive (Anekset, Tabela 8.2)
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, etj.(Anekset, tabela 8.3)

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, i liçensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 225, datë 04.06.2013, është hapur dhe ka pranuar studentët e parë në vitin akademik 2013-2014. Në këtë vit u rregjistruan vetëm 10 studentë. Në këtë program studimi janë rregjistruar në total 86 studentë. Viti akademik 2015-2016 pritet të nxjerrë të dimplomuarit e brezit të parë në këtë program studimi.

Kriteret për pranimin e studentëve dhe procedura e pranimit:

Në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” pranohen për të ndjekur studimet të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar me sukses Maturën Shtetërore dhe të gjithë shtetasit e huaj që kanë përfunduar arsimin e mesëm. Gjithashtu pranohen Studentë të transferuar nga universitete ose shkolla të tjera të larta universitare të vendit apo të huaja. Për tu regjistruar ata duhet të plotësojnë këto kushte:

- Kanë diplomë origjinale të përfundimit të shkollës së mesme
- Diploma të shoqërohet me listën e notave.
- Për të huajt, dëshmi e njohjes së gjuhës shqipe dhe diplomë të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga MASH. Ky ekuivalentim kërkohet edhe për ata studentë shqiptarë që kanë përfunduar studimet jashtë shtetit.
- Pranojnë pagimin e tarifës së programit të studimit.
- Plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara në rregulloren e brendshme të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”.

Sipas Rregullores së SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”, neni 20, procedura e regjistrimit kërkon që studentët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diploma e përfundimit të studimeve të shkollës së mesme;
- Dokumenti i identifikimit;
- 2 fotografi me përmasat 5cm X 5cm;
- Raport mjeko-ligjor i gjendjes shëndetësore;
- Vërtetimin bankar për depozitimin në llogarinë bankare të Universitetit “Mesdhetar” të një shumë të barabartë me tarifën e shkollimit për atë vit mësimor.

Studentët që paraqiten me dokumentacionin e mësipërm, nënshkruajnë një formular aplikimi. Ndjekja e kësaj procedure kryhet nga sekretaria mësimore.

Transferimi i studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose private, për në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” ose anasjelltas, bëhet për programe të njëjta ose të ngjashme, në të njëjtin cikël studimi. Transferimi i studimeve kryhet sipas Rregullores specifike për transferimin e studentëve. Si rregull, Senati Akademik me propozim nga Dekanati ngre komision për transferimin e studimeve, si dhe komisionet e vlerësimit të krediteve të programit të çdo lënde të kryer nga studenti që kërkon të transferohet në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Përputhshmëria e programit të lëndës, për tu pranuar si i transferueshëm me kredite të plota, nuk duhet të jetë nën 70 për qind të temave dhe orëve në auditor. Ky vlerësim nga Komisionet e Lëndëve i kalon Komisionit të Vlerësimit të Krediteve i cili, pasi bën përmbledhjen, dorëzon në Sekretarinë Mësimore Proces Verbalin me gjithë sqarimet e nevojshme e të domosdoshme, si dhe me vendimin përfundimtar mbi lëndët e njohura me kredite të plota apo pjesore, si edhe lëndët e detyrueshme për tu frekuentuar, përgatitur e dorëzuar Projekt/Detyre Kursi dhe shlyerja e provimit përfundimtar.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Për t'u regjistruar, kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit përkatës dokumentacionin e nevojshëm, i cili përbëhet nga:
- Formular aplikimi;

- Dy fotografi;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
- Diplomë origjinale të përfundimit të shkollës së mesme / maturës shtetërore ose;
- Diplomë origjinale të përfundimit të një programi tjetër studimi - nivel ekuivalent;
- Çertifikata përkatëse e notave;
- Vetëm për studime të kryera jashtë shtetit: Ekuivalentim i Diplomës dhe Çertifikatës përkatëse të notave, sipas kritereve të përcaktuara nga MAS;
- Vetëm për të huajt: Dëshmi e njohjes së gjuhës shqipe;
- Raport mjeko-ligjor i gjendjes shëndetësore;
- Dokument i pagimit të tarifës së programit të studimit;

Kushte specifike të pranimit të studentëve

- Nuk ka.

Studentët e regjistruar sipas viteve dhe notat mesatare në hyrje (Anekset, Tabela 9.1)

Numri total i studentëve dhe kalueshmëria e tyre në vite.

Tabela 15 e RVB paraqet një mospërputhje në numrin e studentëve të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi me atë të raportuar gjatë vizitës në institucion.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” na u raportua që gjatë vitit akademik 2014-2015 janë transferuar 5 studentë nga IAL të tjera për në këtë institucion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Mbështetur në Ligjin 9741, dt.21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, për t’u pranuar në një program studimi të ciklit të parë, kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore ose të zotërojë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë shtetit, të vlerësuar ekuivalente me të, ose të zotërojë një diplomë të lëshuar nga një Institucion i Arsimit të Lartë.</p> <p>Kandidati fiton statusin e studentit dhe ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik, nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” brenda afateve kohore të përcaktuara paraprakisht dhe të shpallura.</p> <p>Për t’u regjistruar, kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit përkatës dokumentacionin e nevojshëm, i cili përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formular aplikimi; - Dy fotografi; - Fotokopje e dokumentit të identifikimit; - Diplomë origjinale të përfundimit të shkollës së mesme / maturës shtetërore ose;

	<ul style="list-style-type: none"> - Diplomë origjinale të përfundimit të një programi tjetër studimi - nivel ekuivalent; - Çertifikata përkatëse e notave; - Vetëm për studime të kryera jashtë shtetit: Ekuivalentim i Diplomës dhe Çertifikatës përkatëse të notave, sipas kritereve të përcaktuara nga MAS; - Vetëm për të huajt: Dëshmi e njohjes së gjuhës shqipe; - Raport mjeko-ligjor i gjendjes shëndetësore; - Dokument i pagimit të tarifës së programit të studimit; <p>Për studentët që regjistrohen në programin e studimit BSc. në Informatikë Biznesi nuk aplikohen kërkesa të veçanta.</p> <p>Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i caktuar nga dekanati, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe rezultatet e provimit të pranimit. Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të fakultetit për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Sekretaria ka përgjegjësinë e verifikimit të originalitetit të dokumentacionit të paraqitur (diplomë e maturës shtetërore, apo diplomë universitare), brenda dy muajve nga koha e regjistrimit. Në rast të konstatimit të falsifikimit të dokumentave, studenti përjashtohet nga SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” pa i rimbursuar tarifën e paguar.</p> <p>Studenti duhet të paguajë tarifën vjetore të shkollimit për vitin përkatës akademik, në përputhje me kontratën e nënshkruar me SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”. Në rast mos pagese ai humbet të drejtën për të hyrë në provime.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” i jep studentit numrin e tij të matrikullimit të përcaktuar nga MAS, i cili është unikal, brenda dy muajve nga koha e fitimit të statusit të studentit.</p> <p>Studenti e humbet statusin e tij me marrjen e diplomës, me largimin vullnetar të tij pa përfunduar studimet ose me përjashtimin e tij nga SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij, me anë të formave të disponueshme elektronike, hard copy, broshura etj.</p> <p>Në respekt të Statutit, të rregullores së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave dhe të rregullores së brendshme studentët, me anë të anketimeve vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit para sezonit të provimit, sipas formularëve të miratuar dhe aplikuar nga organet përkatëse të SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, specifikisht NJSBC-ja.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ndjek politika mbështetëse për studentët. Për të nxitur orientimin e studentit drejt tregut të punës dhe sipërmarrjes</p>

	<p>funksiononte Zyra e Karrierës. Kjo hallkë përbëhet nga tre seksione: seksioni i studentëve të ekselencës, ai i stimulimit të karrierës profesionale dhe seksioni i startup-it dhe nxitjes së biznesit. Zyra e Karrierës mbi të gjitha është një mjet për të vendosur në qendër të vëmendjes studentet duke synuar nxitjen e talenteve individuale të tyre. Ajo përfaqëson një nga hallkat kryesore të lidhjes së institucionit me nevojat e tregut të punës, të investimeve dhe sipërmarrjes.</p> <p>Zyra e këshillimit të karrierës funksionon në mënyrë të përhershme me staf me kohë të plotë.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka marrëveshje bashkëpunuese me shoqëri tregtare private, me të cilat realizon edhe kryerjen e praktikës profesionale. Marrëdhëniet që vendosin studentët me këto shoqëri gjatë viteve të studimit janë të tilla që krijojnë marrëdhënie njohje reciproke me punëdhënësin çka mund të çojë pas diplomimit edhe në mundësi punësimi.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Programi i studimit BSc. në Informatikë Biznesi, i cili ka nisur në vitin 2013-2014, këtë vit akademik pritet të regjistrojë të diplomuarit e brezit të parë.</p> <p>Aktualisht, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” statistikat mbi ecurinë e studentëve të programit Bsc. në Informatikë Biznesi i ruan dhe përpunon bazuar në programin MS Excel.</p> <p>Megjithatë, Institucioni është në procesin e implementimit të një sekretarie online, ku do të hidhet çdo veprim që lidhet me studentët, regjistrim, tërheqje, mungesa, provime të kryera, notat etj., mbështetur në të dhëna hard copy. Nëpërmjet kësaj sekretarie do të sigurohen edhe statistikat mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Në kuadër të orientimit dhe këshillimit të studentëve, siç u theksua më lart, është Zyra e Karrierës, një ndër funksionet e të cilit është këshillimi për studentët. Zyra e këshillimit të karrierës ndjek një politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të tutorisë.</p> <p>Për vitin akademik 2015-2016, u bë grupimi i studentëve në grupe (5-8 persona), ku për secilin grup është përcaktuar tutori (mentori), i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore dhe jo vetëm. Për takimet e grupit me tutorin janë përcaktuar orari dhe vendi, të cilat publikohen. Pjesë e procesit të tutoriatit për studentët e vitit të tretë është edhe këshillimi i studentëve për përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.</p>

Konkluzionet e GVJ

Praktikat e ndjekura nga SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” lidhur me politikat e mirëpritjes së studentëve, kujdesit ndaj tyre, politikat e punësimit, etj, përputhen me kriteret e standardeve të përcaktuara. Gjatë vizitës dhe bisedave me grupet e ndryshme në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” pamë se të gjithë studentët e rregjistruar në programin e studimit, Bachelor në Informatikë Biznesi janë rregjistruar sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe atyre të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. U informuam mbi procesin e kujdesit ndaj studentit të cilëve u vihen në dispozicion grupe pedagogësh të cilët u japin informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij, rregulloren e universitetit, statusin e akreditimit, vlefshmërinë e diplomës, mundësitë e transferimit të studimeve, mundësitë e punësimit etj. U mundësuam të shikojmë Zyrën e Karrierës dhe Praktikave e cila mbështeste studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve me konsulencë dhe informacion të vazhdueshëm për mundësitë e punësimit dhe/ose të vazhdimin të mëtejshëm të studimeve.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” është institucion i arsimit të lartë i orientuar nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor. Kërkimi shkencor është pjesë e vlerave të stafit akademik, kontributit në shkencë dhe në shoqëri, rritjes së reputacionit të institucionit dhe pjesëmarrjes së tij në projekte kombëtare e rajonale. SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” nxit dhe inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktiv në veprimtarinë kërkimore. Sipas mundësive dhe buxhetit, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” e ka në politikën e vet të financojë kërkimet shkencore të stafit akademik.

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” u ofron të gjitha lehtësitë dhe mundësitë anëtarëve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore, botim artikujsh dhe monografi. Ajo mbetet motivuese edhe për botime të teksteve mësimore sipas një procedure të diskutimit paraprak në strukturat e shkollës. SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve shkencore, u ka dhënë mundësinë dhe shansin anëtarëve të stafit akademik të shprehin pikëpamjet e tyre në lidhje me zhvillimet e vendit.

Sipas statutit SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilit do që kërkon të përfitojë nga arsimit i lartë privat në një mjedis stimulues dhe mirëpritës. Me misionin e tij, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka për qëllim nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.

Për këtë, institucioni promovon stafin për kërkime eventuale shkencore me anë të financimit të shpenzimeve për pjesëmarrjen në konferenca, për botime në formën e artikujve shkencorë, për projekte kërkimore etj. Për më tepër, në SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është krijuar Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit Shkencor që funksionon si njësi bazë e fakultetit dhe realizon veprimtari shkencore dhe kërkimore. Bën analiza të punës mësimore-kërkimore në fakultet së bashku me përgjegjësit e departamenteve dhe propozon masa për përmirësimin e mëtejshëm të saj. Qëllimi është të krijohen kushte dhe lehtësira për pedagogët, jo vetëm me financime të projekteve të tyre eventuale të sipërpërmendura, por dhe duke mundësuar pjesëmarrjen e anëtarëve të stafit në të tilla evente të thirrur nga kontakte dhe partnerë të institucionit.

Institucioni nëpërmjet qendrave kërkimore, në bashkëpunim me departamentet, kërkon të nxisë debatin dhe të thellojë kërkimin shkencor, nëpërmjet organizimit të seminareve dhe konferencave ndërkombëtare shkencore. SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” deri tani ka organizuar 3 konferenca shkencore ndërkombëtare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

(Anekset, Tabela 10.1: Aktivitetet shkencore)

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka vendosur marrëdhënie me shumë institucione private dhe publike, vendase dhe të huaja, shoqëri tregtare private, organizata jofitimprurëse duke i konsideruar si prioritet i lidhjes së teorisë me praktikën. Marrëdhëniet me jashtë janë mbajtur dhe zhvilluar nga Presidenti dhe rektori i SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë”.

Bashkëpunimi i departamentit të Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës, nëpërmjet SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka qenë i mundur si në nivel lokal, kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

- Në nivel lokal: Memorandumin e Bashkëpunimit të SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” me Njësinë bashkiake Nr.1 në Tiranë, me Bashkinë Durrës dhe me Bashkinë Sarandë.
- Në nivel kombëtar: Marrëveshje Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, Memorandum Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit etj.
- Në nivel ndërkombëtar: Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” dhe Akademisë Diplomatike të Londrës, Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Universitetin e Tuzlës në Bosnjë-Hercegovinë; LUM Jean Monnet University, Casamassima(BA), Itali; Universitetin e Qipros; Universitetin e Strugës; Kolegjin Universitar “Biznesi” me seli në Prishtinë etj.

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar, duke mundësuar dhe financuar pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme akademike brenda dhe jashtë vendit, ku kanë marrë pjesë disa anëtarë të personelit të tij akademik.

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” është anëtar i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS. Si anëtar i këtyre rrjeteve, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” është në marrëdhënie dhe bashkëpunim të vazhdueshëm në formë projektesh të përbashkëta dhe shkëmbimi akademik me universitetet anëtare të këtij rrjeti. Gjithashtu ajo ka marrëdhënie bashkëpunimin me: Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë të Tiranës; Aleancën e Biznesit të Kosovës; Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë; Shoqatën e Bankave të Shqipërisë; Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë; Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit etj.

Të shumta dhe të efektshme janë lidhjet që SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka krijuar dhe realizuar me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës si B&T Sistem; INSTAT; Institutin e Modelimeve në Biznes; Drejtorinë e Pëgjithshme të Tatimeve; Bankën e Shqipërisë; BNT Elektronics; A&D Business Consulting, etj. Në qendër të këtyre marrëveshjeje është bashkëpunimi në fushat me interes të ndërsjelltë, realizimi i praktikave mësimore të studentëve si dhe punësimi i tyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

(Anekset, Tabela 10.2: Aktivitetet shkencore në kuadër të bashkëpunimeve)

(Anekset, Tabela 10.3: Institucionet bashkëpunuese)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka krijuar kushte të cilat lehtësojnë shkëmbimin e informacionit. Pedagogët dhe pjesëtarët e tjerë të institucionit kanë adresën e tyre të postës elektronike institucionale. Shkëmbimi i informacionit nëpërmjet përdorimit të postës elektronike është forma kryesore e komunikimit në të gjitha nivelet.</p> <p>Ndarja e detyrave të personelit është e përcaktuar qartësisht në statutin, rregulloret dhe në dokumentet e përshkrimit të punës (Job Description). Në statut janë përcaktuar qartë njësitet përgjegjëse për analizën e punës së stafit dhe mënyrat e vlerësimit. Qartësia në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive konsiderohet një element që shmang problemet mbi përgjegjësitë dhe rolet, dhe në këtë mënyrë garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit.</p> <p>Në mbylljen e semestrit e të vitit akademik bëhet analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore. Gjithashtu në departament miratohen temat studimore, kualifikimet, projektet, punën kërkimore-shkencore, bashkëpunimet me departamentet e tjera, brenda e jashtë institucionit. Bëhen referimet për pedagogët e këtij profili të përfshirë në programin e doktoraturës, si dhe leksione të hapura për të gjithë personelin që synon të marrë tituj shkencorë si Prof. Asoc. dhe Prof. Dr.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në funksion të realizimit sa më mirë të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në të gjithë programet e studimit (ku përfshihet edhe programi i studimit BSc. në Informatikë Biznesi), SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka marrëdhënie me shumë institucione private dhe publike, vendase dhe të huaja, shoqëri tregtare private, organizata jofitimprurëse duke i konsideruar si prioritet i lidhjes së teorisë me praktikën.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” dhe Akademisë Diplomatike të Londrës, Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Universitetin e Tuzlës në Bosnjë-Hercegovinë; LUM Jean Monnet University, Casamassima(BA), Itali; Universitetin e Qipros; Universitetin e Strugës; Kolegjin Universitar “Biznesi” me seli në Prishtinë etj.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka krijuar dhe</p>

	<p>realizuar me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës si B&T Sistem; INSTAT; Institutin e Modelimeve në Biznes; Drejtorinë e Pëgjithshme të Tatimeve; Bankën e Shqipërisë; BNT Electronics; A&D Business Consulting, etj. Në qendër të këtyre marrëveshjeje është bashkëpunimi në fushat me interes të ndërsjelltë, realizimi i praktikave mësimore të studentëve si dhe punësimi i tyre.</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, organizon takime, seminare, leksione në bashkëpunim me shumë institucione publike e private për njohjen e studentëve me mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe tregun e punës.</p> <p>Në fund të çdo viti kalendarik bëhet një raport përmbledhës mbi realizimin e marrëveshjeve kontraktuale për realizimin e programeve mësimore dhe kur ka probleme financiare, pasqyrohen në bilancet vjetore.</p>
<p>Konkluzionet e GVJ</p> <p>SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” garanton bashkëpunimin e brendshëm dhe të jashtëm sipas kriteve të standardeve të përshkruara më sipër. Ajo ka krijuar kushte të cilat lehtësojnë shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve. Ndarja e detyrave të personelit është e përcaktuar qartësisht në statutin, rregulloret dhe në dokumentet e përshkrimit të punës. Në funksion të realizimit sa më mirë të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në të gjithë programet e studimit (ku përfshihet edhe programi i studimit BSc. në Informatikë Biznesi), SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka marrëdhënie me shumë institucione private dhe publike, vendase dhe të huaja, shoqëri tregtare private, organizata jofitimprurëse duke i konsideruar si prioritet i lidhjes së teorisë me praktikën.</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me **“Analizën përmbledhëse të RVJ”** sipas metodës **SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-Mundësitë, Threats-pengesat)**.

a. Pika të forta:

- 1) Stafi akademik i SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” është shumë i kualifikuar. Numrin më të madh të tyre e zënë pedagogë me tituj dhe grada shkencore që nga Akademikë, Profesorë, Profesorë të Asociuar dhe Doktor. Kjo përbën një avantazh shumë të madh si në aspektin e mësimdhënies edhe atë të kërkimit shkencor.
- 2) Mjediset e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” janë të vendosura në një godinë të re e cila për nga ana arkitekturore vendos në dispozicion të studentëve sasi të mjaftueshme ambientesh të përshtatshme për mësimdhënie. Këto ambiente janë të pajisura me mjete dhe infrastrukturë bashkëkohore dhe plotësojnë nevojat për realizimin e objektivave të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.
- 3) Ngritja e SHLP “Mesdhetare të Shqipërisë” si projekt jofitimprurës i mundëson këtij institucioni të jetë i fokusuar në përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij, dhe jo ta konsiderojë atë thjesht si një biznes fitimprurës për rritjen e të cilit mund të kërkohet të bëhen kompromise edhe me cilësinë.
- 4) Numri i madh i marrëveshjeve të bashkëpunimit sidomos me universitete dhe qendra akademike si brenda dhe jashtë vendit, por jo vetëm, është faktor i rëndësishëm në rritjen e vazhdueshme të nivelit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, duke bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencave më të mira në fushën akademike dhe më gjërë.

b. Pika të dobëta:

- 1) Numri i vogël i kompjuterave në laborator në krahasim me numrin e studentëve të progamit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi pengon zhvillimin në mënyrë adekuate të lëndëve që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e tyre, dhe aftësimin e studentëve për të përdorur në praktikë njohuritë e marra në teori nëpërmjet programeve kompjuterike.
- 2) Mungesa e abonimeve në periodikë shkencorë bashkëkohorë apo portale që ofrojnë shërbim të tillë (si IEEE, ACM, Webscience, etj.) kufizon mundësitë e pedagogëve pa grada në përvetësimin e mëtejshëm të njohurive të përditësuara dhe tendencave të reja të kohës.

c. Mundësitë:

- 1) Zhvillimi i tregu të punës me kërkesa në rritje për personel me aftësi të integruara si në informatikë dhe teknologji informacioni ashtu edhe administrimin e biznesit dhe financave krijon mjedis të përshtatshëm dhe inkurajues për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.
- 2) Përfshirja e studentëve në implementimin e projekteve të ndryshme që lidhen me teknologjinë e informacionit, brenda dhe jashtë këtij institucioni, është një faktor i rëndësishëm që ndikon në rritjen e besimit në kualitetet e këtij programi studimi dhe mundësitë që ai jep për punësimin e të diplomuarve në të ardhmen.
- 3) Përfshirja e pedagogëve dhe studentëve në programe të tilla si TEMPUS, CEEPUS, Erasmus+, etj, do të jetë një mundësi e mirë për të përfituar nga shkëmbimi i eksperiencave me instituciont homologe të huaja.

d. Pengesat:

- 1) Rritja e kuotave të pranimit në universitetet shtetërore të studentëve në degë të ngjashme si dhe hapja e degëve të ngjashme në shumë universitete të tjera mund të përbëjë një pengesë në rritjen e këtij programi studimi.
- 2) Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë mund të krijojë një pengesë në hartimin e strategjive afatgjata.

SWOT Analysis**a. Strengths:**

- 1) "SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë"" has a well qualified academic staff. Most of academic personnel holds an academic title or degree like Academic, Professor, Associated Professor or Doctor. This is a great advantage both on teaching and research.
- 2) The facility where "SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë"" operates is quite new and ensures that sufficient space both in quantity and quality is available to students and teachers for their academic activities. Moreover, the facility is equipped with a modern infrastructure that meets the need to achieve the objectives of the study program Bachelor in Business Informatics.
- 3) Establishment of "SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë"" as part of a non-profit organization provides the ground for greater focus on academic activities rather than profits.
- 4) The large number of cooperation agreements especially with universities and research centers, both national and international, is an important factor to ensure continued growth in quality of teaching and research activities.

b. Weaknesses:

- 1) The small number of computers in labs compared to the number of students enrolled in study program of Bachelor in Business Informatics makes it difficult for students to properly practice the knowledge acquired in theory.
- 2) Lack of subscription on scientific journals or portals that offer such service (e.g IEEE, ACM, Webscience,etc.) limits the opportunities of lecturers (especially those who are in process of PhD studies) to have access on the latest scientific progress and trends.

c. Opportunities:

- 1) The growing market demand for employees with integrated knowledge both in information technology and business administration or finance provides a convenient and encouraging environment for the study program of Bachelor in Business Informatics.
- 2) Involvement of students in different information technology projects implementation, both internal and external, is an important factor to increase the confidence in the quality and the employment opportunities that this study program offer to its graduated students.
- 3) Involvement of lecturers and student in international exchange programs like TEMPUS, CEEPUS, Erasmus + provides opportunities for experience exchange with foreign affiliates.

d. Threats:

- 1) The increase of acceptance quotas in public universities for similar study programs and existence of similar study programs in many universities (both public and private) hinders the growth of this study program in “SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë””.
- 2) Frequent change of legal framework of higher education may inhibit development of long term development strategies.

ANEKSET

Tabela 2.1: Antarët e Këshillit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike

Nr.	Antarët e Këshillit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike	Funksioni
1.	Prof. Asoc. Dr. Alqi Naqellari	Kryetar – Dekan
2.	Dr. Ira Zoga (Gjika)	Anëtar – Përgjegjës Departamenti
3.	Dr. Rudina Qurku	Anëtar – Përgjegjës Departamenti
4.	Dr. Dolantina Hyka	Anëtar – Përgjegjës Departamenti
5.	Prof. Asoc. Dr. Pashk Lekaj	Anëtar – Pedagog Efektiv
6.	Dr. Nikollaq Pano	Anëtar – Pedagog Efektiv

Tabela 2.2: Struktura Didaktike e Fakultetit të Shkencave Ekonomike

Drejtuesit e Njësive Bazë të Fakultetit të të Shkencave Ekonomike	
Dr. Ira Zoga (Gjika)	Përgjegjës i Departamentit të Ekonomisë
Dr. Rudina Qurku	Përgjegjës i Departamentit të Financës, Bankës dhe Kontabilitetit
Dr. Dolantina Hyka	Përgjegjës i Departamentit të Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës
Prof. Asoc.Dr. Përparim Kabo	Përgjegjës i Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit “Instituti për Reforma dhe Zhvillim”

Tabela 2.3: Numri i Personelit Akademik për Njësitë Bazë të Fakultetit të Shkencave Ekonomike

IAL	Fakulteti i Shkencave Ekonomike						
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Total
	Gjithsej	Tituj/Grada	Gjithsej	Tituj/Grada	Gjithsej	Tituj/Grada	
Dep. i Ekonomisë	8	7	7	7	4	1	19
Dep. i Financës, Bankës	9	5	8	5			17
Dep. i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës	12	6	9	7			21
Qendra e kërkimit dhe zhvillimit “Instituti për Reforma dhe Zhvillim”	4	2	-	-			4
Në total	33	23	24	21	4	1	61

Shënim: PA është në shërbim të Fakultetit të Ekonomisë dhe i shërben të tre Njësive kryesore

Tabela 3.1. Numri i personelit akademik për Departamentin e Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës sipas titujve dhe gradave

IAL	Fakulteti i Shkencave Ekonomike: Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës.							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada

Fakulteti Shkencave Ekonomike	1	Prof.	3	Prof.			4	Prof.
	3	Prof.As.	1	Prof.As.			4	Prof.As.
	2	PhD/Dr.	3	PhD/Dr.	1	PhD/Dr.	6	PhD/Dr.
	6	MSc/MP	2	MSc/MP.	3	MSc/MP.	11	MSc/MP.
Në total	12		9		4		25	

Tabela 3.2. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë për Departamentin e Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës sipas titujve dhe gradave

Fakulteti i Shkencave Ekonomike: Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada.	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada.	Institucioni ku punon full time.
1	Dolantina Hyka	Shef	PhD/Dr.	1	Bukurie Dumani	Prof	Universiteti i Tiranës.
2	Greta Angjeli	Anëtar	Prof.As.	2	Kozeta Sevrani	Prof.	Universiteti i Tiranës.
3	Gudar Beqiraj	Anëtar	Prof.	3	Neki Frashëri	Prof.	Universiteti Politeknik i Tiranës.
4	Marenglen Bukli	Anëtar	Prof.As.	4	Sotir Rrapo	Prof. As.	Instituti i Zhvillimit të Arsimit.
5	Pashk Lekaj	Anëtar	Prof.As.	5	Bojken Shehu	PhD/Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës.
6	Mimoza Ahmeti	Anëtar	PhD/Dr.	6	Elira Hoxha	PhD/Dr.	Universiteti i Tiranës.
7	Drita Avdyli	Anëtar	MSc/MP.	7	Anita Çausi	PhD/Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës.
8	Ela Tollkuci	Anëtar	MSc/MP.	8	Katerina Male	MSc/MP.	Praktikë e lirë.
9	Klodjan Lula	Anëtar	MSc/MP.	9	Blerta Moçka	MSc/MP.	Universiteti Bujqësor i Tiranës.
10	Marinela Shehaj	Anëtar	MSc/MP.				

11	Eniana Dupi	Anëtar	MSc/MP.				
12	Erdet Lalaj	Anëtar	MSc/MP.				

Tabela 3.3 Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për personelin në Departamentin e Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës

	Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës.		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	1	3	1-3
Profesorë të Asoc.	3	1	3-1
Doktorë	2	3	2-3
Pedagogë (pa tituj)	5	2	5-2
Asistentë me Master	1	-	1-0
Asistentë pa Master	-	-	-
Personeli Administrativ	4	-	4-0

Tabela 3.4 Të dhënat sipas seksit për personelin në Departamentin e Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës

Titulli	Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës.		
	PAE Femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	-	1	1-0
Profesorë të Asoc.	1	3	3-1
Doktorë	2	-	0-2
Pedagogë (pa tituj)	4	1	1-4
Asistentë me Master	-	1	1-0
Asistentë pa Master			
Personeli Administrativ	2	2	1-1

Tabela 3.5 Të dhënat sipas moshës për personelin akademik efektiv dhe administrativ në Departamentin e Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës

Personeli sipas titujve /gradave.	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë:					
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)	(69-75)
Profesorë					1	

Prof. Asoc.			1		2	
Doktorë	1		1			
Pedagogë (pa tituj)	3	1	1			
Asistentë me Master	1					
Asistentë pa Master						
Personeli Administrativ	3			1		

Tabela 3.6 Të dhënat sipas moshës për personelin akademik me kontratë në Departamentin e Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës

Personeli sipas titujve /gradave.	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë:					
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)	(69-75)
Profesorë				3		
Prof. Asoc.				1		
Doktorë	3					
Pedagogë (pa tituj)	2					
Asistentë me Master						
Asistentë pa Master						

Tabela 4.1: Mjediset e institucionit

Mjediset e SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë".	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione.	7	558.2 m ²
Klasa për seminare.	10	398.4 m ²
Salla për aktivitete promovuese/Leksione.	1	104 m ²
Laboratorë informatike.	2	70 m ²
Salla interneti	1	46.4 m ²
Salla për bibliotekë.	1	107 m ²
Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1	35.2 m ²
Zyrë informacioni për studentët.	1	37.6 m ²
Korridore/holle.	12	748.2 m ²
Nyje hidrosanitare për studentët.	31	132 m ²
Nyje hidrosanitare për personelin akademik.	13	48.5 m ²

Tabela 4.2: Mjediset për stafin

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Rektoratin.	7	484.6 m ²
Zyra për sekretarinë mësimore.	1	37.6 m ²
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore.	2	20 m ²

Zyra për personelin akademik	6	103.9 m ²
Zyrë për financën.	1	9 m ²
Zyrë për Njësinë e SBC.	1	14 m ²
Salla për mbledhje.	1	54 m ²
Mjedis për stafin e shërbimit.	2	31.2 m ²
Mjedise shlodhëse si kafeteri - fastfood - restorant.	1	120 m ²

Tabela. 5.1: Pasqyra e të ardhurave e SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”.

N R	Të Ardhurat nga.	Vitet				
		2011	2012	2013	2014	2015
A	Fonde Publike.					
1	Pushteti qendror.					
2	Pushteti vendor.					
	Gjithsej.					
B	Fonde Jopublike.					
1	Grantet për kërkime dhe kontratat.					
2	Konsulencat dhe shërbimet.					
3	Tarifat për dhe gjatë shkollimit.	40,539.40	94,397.41	107,400.97	132,118.40	193,772.01
4	Sponsorizimet.		2,049.80			
5	Shërbimet trajnuese (kualifikimi ivazhdueshëm).					
6	Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione.					
7	Aktivitetet tregëtare (mensa, Kafe, bare, rezidencat etj).			768.84	650.84	651.21
	Gjithsej	40,539.40	96,447.21	108,169.81	132,769.24	194,423.22
	Shuma	40,539.40	96,447.21	108,169.81	132,769.24	194,423.22

Tabela. 5.2: Pasqyra e shpenzimeve e SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”.

N R	Shpenzimet	Vitet														
		2011			2012			2013			2014			2015		
		Paga	Shpenzime	Investime	Paga	Paga	Shpenzime	Investime	Paga	Paga	Shpenzime	Shpenzime	Investime	Shpenzime	Shpenzime	Investime
A	Fonde Publike.															
1	Pushteti qendror.															
2	Pushteti vendor.															
	Gjithsej															
B	Fonde joPublike.															
1	Grantet për kërkime dhe kontratat.															
2	Konsulencat dhe shërbimet.															

3	Tarifat për dhe gjatë shkollimit.	11,662.10	41,540.40	22,656.10	24,963.00	68,334.50	5,987.00	30,265.80	68,131.30	1118.62	30,265.20	83,170.40	8,379.60	62,306.01	83,883.71	14,585.45
4	Sponsorizimet					2,049.80										
5	Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm).															
6	Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione															
7	Aktivitetet tregëtare (mensa, Kafe, bare, rezidencat etj).															
	Gjithsej	11,662.10	41,540.40	22,656.10	24,963.00	70,384.30	5,987.00	30,265.80	68,131.30	1118.62	30,265.20	83,170.40	8,379.60	62,306.01	83,883.71	14,585.45
	Shuma	11,662.10	41,540.40	22,656.10	24,963.00	70,384.30	5,987.00	30,265.80	68,131.30	1118.62	30,265.20	83,170.40	8,379.60	62,306.01	83,883.71	14,585.45

Shpenzimet në pesë vitet e fundit sipas burimit të financimit (Aneksat, Tabela. 5.2).

Tabela. 6.1: Anëtarët e NJSBC

NR	Anëtarët e NJSBC.	Detyra që kanë NJSBC.	Sa kohë ka në këtë detyrë.
1	Magi Cici	Specialiste	3 vjet
2.	Andi Teqja	Koordinator	3 vjet
3.	Laura Xhaxhiu	Specialiste për punën kërkimore.	1 vit

Veprimtaritë formuese (A- F)

- Disiplina të formimit të përgjithshëm: **A**
- Disiplina karakterizuese: **B**
- Disiplina të ngjashme ose/dhe integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese: **C**
- Disiplinat me zgjedhje të studentit: **ndërdisciplinat e ofruara nga institucioni D**
- Njohuri të tjera formuese, si plotësime në Gjuhë të huaja, informatikë, prezantuese, Stazh apo praktikë, etj. **E**
- Teza e Diplomës, provim përfundimtar:

Tabela 8.1: Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

Bachelor në Informatikë Biznesi	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor

a.	Leksione	1050
b.	Seminare	735
c.	Praktikë profesionale	120
d.	Orë konsultime	20
	Në total	1925

Tabela 8.2: Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10%
Testimet gjatë vitit	20%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Tabela 8.3: Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, etj.

	Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
1	Për punime shkencore individuale të pedagogëve.	4
2	Për projekte shkencore në rang Departamenti.	8
3	Për projekte shkencore në rang Fakulteti.	15
4	Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	5

Tabela 9.1: Studentët e regjistruar sipas viteve dhe notat mesatare në hyrje

Programi i studimit BSc në Informatikë Biznesi	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
2013-2014	10	6.8	S'KA	-
2014-2015	21	6.5	S'KA	-
2015-2016	50	6.7	S'KA	-
Në total	81		S'KA	-

Tabela 10.1: Aktivitetet shkencore

Aktivite të planifikuara individuale dhe në rang Njësie bazë në pesë vitet e fundit.		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL.	Rreth 200 botime.
2.	Numri i projekteve të zbatuara.	13 projekte.
3.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL.	3 Konferenca Shkencore Ndërkombëtare.
4.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL.	Të gjithë pedagogët e departamentit të Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës kanë marrë pjesë në aktivitetet shkencore të organizuara nga SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë".
5.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor.	Të gjithë pedagogët e departamentit të Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës zhvillojnë kërkim shkencor lidhur me procesin mësimor sipas fushës përkatëse të studimit.
6.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor.	15 studentë (Punimet janë në proces).

Tabela 10.2: Aktivitetet shkencore në kuadër të bashkëpunimeve

Aktivite shkencore individuale dhe në rang Njësie bazë në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në pesë vitet e fundit.		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare.	13
2	Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj.	186 orë mësimore
3	Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit.	10
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL.	-
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor.	UMSH Press, Revista periodike EUROMEDITERRANEAN
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime.	95
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	-

Tabela 10.3: Institucionet bashkëpunuese

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese.		
Institucionet qeveritare bashkëpunuese.		Lloji i bashkëpunimit.
1	Ministri.	Praktikë mësimore.
2	Institucione shtetërore.	Praktikë mësimore.
3	Institucione financiare.	Praktikë mësimore.
Organizatata Profesionale.		Lloji i bashkëpunimit.
1	Dhoma e Tregëtisë dhe e Industrisë Tiranë.	Kualifikimi dhe punësimi i

		studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
2	B&T Sistem.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
3	Instituti i modelimeve në biznes.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
4	Dhoma Kombëtare e Avokatisë.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
5	BNT Electronics.	
6	Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
7	A&D Business Consulting.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
Komuniteti i biznesit, tregu i punës.		Lloji i bashkëpunimit.
1	Dhoma e tregëtisë dhe e industrisë Tiranë.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
2	B&T Sistem.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
3	Instituti i modelimeve në biznes.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
4	Dhoma Kombëtare e Avokatisë.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
5	BNT Electronics.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP

		Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.
6	A&D Business Consulting.	Kualifikimi dhe punësimi i studentëve të diplomuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, si dhe realizimi i projekteve të përbashkëta.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli